



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E AUDITIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Objekti i auditimit: Auditimi i sistemeve, përputhshmërisë dhe financiar.

Subjekti i audituar: Agjencia e Trajtimit të Kredive

Subjekti auditues: Drejtoria e Auditimit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

I. Përmbledhje ekzekutive

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 06.11.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe planit të auditimit nr.8867/4 datë 02.06.2023 është kryer një mision auditimi në Agjensinë e Trajtimit të Kredive për auditimin e sistemeve, përputhshmërisë dhe auditimin financiar.

Gjetje kryesore:

- Rregullorja e ATK-së ka të përcaktuara detyrat funksionale të punonjësve të saj, por nuk është e harmonizuar sipas komponentëve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Këshilli Mbikëqyrës gjithashtu nuk ka miratuar rregulloren e funksionimit të tij e cila do të përmirësonte komunikimin administrativ me drejtorinë e agjencisë.
- ATK bazuar në nenin 10 nr. 8894 datë 14.5.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë:
 - Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shtator të vitit 2014,
 - ALUIZNI në gusht 2015,
 - Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në mars 2018.
 - Marrëveshje me Bankën e Shqipërisë në qershor 2020.
- Agjencia nuk i ka përcaktuar në rregullore procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore, si procedurat e shpalljes, emërimit/largimit të stafit.
- Pozicionet e lira të punës në agjensi janë shpallur në faqen zyrtare të internetit të institucionit, por nuk është kërkuar të shpallen në Portalin Kombëtar të Punësimit", apo në forma të tjera të informimit të publikut, për të garantuar vizibilitet dhe konkurrencë në përthithjen e stafit.
- Referuar lëvizjeve të stafit për periudhën objekt auditimi rezultojnë 35 emërimet gjithësej, 35 largime gjithësej të stafit nga të cilët 32 me dorëheqje dhe 3 me masë disiplinore, 27 lëvizje të brendshme të stafit të ATK-së, (ndryshime pozicionesh). Ka pasur lëvizje të shpeshta të stafit të cilat kanë rritur riskun e vazhdimësinë së proceseve të punës së institucionit.
- Nga vlerësimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve ato rezultojnë të plota dhe kanë bashkëngjitur dokumentacionin përkatës sipas kodit të punës, janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës, është kryer vlerësimi i performancës së punës së stafit.

- Rezultori se nuk janë vlerësuar çdo vit risqet që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive së agjencisë sipas legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Referuar nenit 14 të ligjit Këshilli i Mbikëqyrës i Agjencisë nuk ka raportuar me shkrim çdo 6 muaj përpara Këshillit të Ministrave mbi veprimtarinë e agjencisë.
- Në referencë të nenit 12 të ligjit për ATK-në për anëtarëve të këshillit mbikëqyrës përfaqësues të Këshillit të Ministrave dhe Bankës së Shqipërisë, ju ka mbaruar mandati 3-vjeçar.
- Në rregulloren e miratuar të institucionit kompetencat e anëtarëve të drejtorisë (drejtor dhe 2 zv/drejtor) nuk janë të përcaktuara qartë. Drejtoria ka funksionuar pa një kuadër procedural të mirëpërcaktuar.
- Drejtoria i ka relatuar këshillit mbikëqyrës planet e veprimit për vitet 2020-2023 ku është paraqitur gjëndja e debitorëve dhe problematikat në mbledhjen e debisë, trajtimi ligjor, ankandet, marrëveshjet institucionale.
- Janë kryer raportimet në ministrinë e financave dhe ekonomisë për çdo vit.
- Aktualisht janë në ndjekje 10782 debitorë nga të cilët 1809 prej tyre kanë urdhra ekzekutimi origjinal, 5427 kanë urdhra ekzekutimi dublikatë dhe 3546 prej tyre nuk kanë të lëshuar urdhëra ekzekutimi ose nuk ka informacion.
- Referuar ndjekjes së debitorëve dhe suksesit të arktëtimeve për vitet 2020-2022 konstatohet se vjelja e detyrimeve është realizuar nga arkëtimet e debitorëve për llogari të ATK-së 152,158,420 lekë ose 88.9 %, nga arkëtimet e përmbaruesve privat për llogari të ATK-së 17,838,991 lekë ose 10.4 %, nga arkëtimet e përmbaruesve shtetëror për llogari të ATK-së 1,213,286 lekë ose 0,7 %.
- Në kundërshtim me udhëzimin e përbashkët të Ministrit Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit Drejtësisë nr.385/7 datë 28.06.2017 i ndryshuar me udhëzimin e përbashkët nr.30 datë 30.08.2018 dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin janë kryer pagesa nga agjencia pa pasur në dispozicion dokumentacion justifikues në shumën 3,907,305 lekë për shpenzimet e administrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit.
- Janë kryer pagesa nga agjencia për tarifën e kalimeve të pronësisë mbi tarifën e përcaktuar të udhëzimit në total me diferencë 799,585 lekë.
- Referuar pasurive të paluajtshme të marra në kalim pronësie nga përmbaruesit gjyqësor privat për 10 pasuria nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur dhe nuk janë regjistruar në kontabilitet për secilin debitor. Nuk ka procedura të mëtejshme të ndjekura për nxjerrjen e çertifikatave të pronësisë.
- Raporti i shpenzimeve të kryera ndaj arkëtimeve të realizuara është në masën: 73,7 %, për vitin 2020; 50,51 % për vitin 2021; 72,9 % për vitin 2022 nga 25% që është kufiri ligjor i shpenzimeve.
- ATK-ja nuk disponon çertifikatë pronësie për 18 pronat e sekestruara ndër vite por ka vetëm vërtetim hipotekor pa harta treguese dhe planvendosje të këtyre pasurive.
- Për inventarizimin e vlerave materiale , janë mbajtur procesverbale të cilat janë të firmosura nga të gjithë antarët e komisionit dhe punonjësit përgjegjës material. Diferencat midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike janë të cituara në procesverbale.
- Nga pasqyrat e gjendjes së llogarisë “Kredi të humbura” jashtë bilancit nga viti 2016 deri në vitin 2022, rezultoi se, niveli mesatar vjetor i arkëtimit për principalin në lekë është 1.2% në vit, për principalin në euro është 0.9% në vit dhe për principalin në dollar është 0.7% në vit.
- Agjencia referuar nenit 8, pika 1 të ligjit, në aktiv të bilancit nuk ka të pasqyruara si debitor kreditë e transferuarara tek kjo agjenci nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, por këto kredi i mban jashtë bilancit në një pasqyrë “Kredi të humbura”. Mbajtja jashtë bilancit si “Kredi të humbura” është bërë me argumentin se këto debi janë 100% të provigjionuara.
- Debitorët e ATK-së, nuk janë krijuar nga veprimtaria e kësaj Agjencie, por janë debitorë të bankave të transferuara tek kjo agjenci në zbatim të ligjit. Për rrjedhojë provigjionimi i tyre nuk mund të bëhet nga ATK, por vetëm nga shteti me akte ligjore.

- Ndjekja e arkëtimit të detyrimeve, nga sektori i financës, bëhet bazuar në të dhënat e hedhura në programin e kreditit më 01.01.2004, të dhëna të cilat janë integruar në sistemet e kreditimit të ndërtuara në periudha të mëvonshme.
- Sektori i financës nuk prodhon raporte kontabël sipas përcaktimit në aneksin nr.2, Moduli Financiar i kontratës nr.896/20, datë 05.05.2022, me përjashtim të raporteve mbi arkëtimin e kredive dhe të pagesave për shpenzime, raporte të cilat kanë qenë prodhuar dhe para ndërrimit të këtij sistemi. Aktualisht kontabiliteti mbahet manualisht në excel me sitemin ditar centralizator.
- ATK, ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022. Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021 janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa Pasqyrat financiare të vitit 2022 janë hartuar nga Sektori i Financës, por aktualisht nuk ka një analizë dhe miratim të tyre nga Këshilli Mbikëqyrës i ATK-së.
- Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021 janë audituar nga ekspertë kontabël të autorizuar pas miratimit në Këshillin Mbikëqyrës, për rrjedhojë Raportet e auditimit nuk i kanë shërbyer vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës në miratimin e treguesëve financiar të vitit por vetëm drejtorisë për rregullimet e rekomanduara.
- ATK, për vitin 2020, ka derdhur në buxhetin e shtetit 5,567 mijë lekë, ose 11% të arkëtimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 45,250 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 89%. Për vitin 2021, ka derdhur në buxhetin e shtetit 20,219 mijë lekë ose 26% të arkëtimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 57,424 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 76%. Për vitin 2022, ka derdhur në buxhetin e shtetit 29,566 mijë lekë ose 51% të arkëtimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 29,566 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 49%. ATK, përveç pagesave të kredisë ndaj KFË nuk ka bërë asnjë derdhje tjetër në buxhetin e shtetit. Shuma e mbajtur nga arkëtimet e vitit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve korrente të vitit, si dhe gjendje në bankë.
- Në kundërshtim me nenin 22, pika 2 të ligjit ATK ka mbajtur në llogarinë e saj në vitin 2020 shumën 32,566 mijë lekë ose 64% të totalit të arkëtimeve të vitit, në vitin 2021, shumën 38,013 mijë lekë ose 49% të totalit të arkëtimeve të vitit dhe në vitin 2022, shumën 14,521 mijë lekë ose 24% të totalit të arkëtimeve të vitit.
- Megjithëse, kështet për pagesë principali dhe interesa të kredisë ndaj KFË, të dërguara nga drejtoria e borxhit publik nuk janë objekt i veprimtarisë së ATK-së, nga kjo e fundit janë kontabilizuar si shpenzime të vitit në kredi të llogarisë "Kreditor të tjerë" KFË.
- ATK, nuk ka shlyer detyrimet vjetore ndaj KFË për të gjithë shumën e marrë nga Drejtoria e Borxhit Publik, për rrjedhojë detyrimet ndaj buxhetit të shtetit për mosshlyrje të kësteve vjetore janë rritur. Gjithashtu është rritur dhe teprica e llogarisë "Kreditorë të tjerë" me analizë KFË.
- Për vitet 2020, 2021 dhe 2022, detyrimi ndaj KFË –së është rritur me 948 mijë euro.
- Detyrimi ndaj KFË-së me 31.12.2015 ishte 330 mijë euro dhe më 31.12.2022 ka arritur në shumën 1,809 mijë euro duke u rritur për 7 vite me 1,479 mijë euro ose 4.5 herë më shumë se gjendja në fund të vitit 2015.
- Ritmi i rritjes së detyrimit të pashlyer ndaj KFË-së, përfaqëson mosderdhje në buxhetin e shtetit të shumave sipas kësteve të dërguara nga drejtoria e borxhit publik. Ky ritëm tregon për një përkeqësim të performancës së ATK-së.

› Konkluzion i përgjithshëm:

Sistemi i kontrollit brendshëm i agjencisë ka funksionuar me mangësi të theksuara. Agjencia nuk ka përmbushur misionin që i ka ngarkuar ligji.

I. Hyrje

Në këtë Raport janë paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit pas përfundimit të misionit auditues të kryer në Agjencinë e Trajtimit të Kredive. Fushat e auditimit sipas parashikimit në Planin e auditimit është për auditimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përputhshmërisë dhe auditimin financiar.

Auditimi është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fushën e auditimit të brendshëm të sektorit publik.

Ky auditim u krye në përputhje me kuadrin ligjor të mëposhtëm :

- Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar.
- VKM nr.681, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive", të ndryshuar.
- Udhëzim nr.33, datë 24.9.2010 "Për trajtimin e kredive të transferuara etj".
- Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Auditimi i planifikuar ka filluar me datë 05.06.2023 sipas njoftimit nr.8867/3 datë 29.05.2023. Në përfundim të punës në terren, u krye takimi i mbylljes në subjektin ku u diskutuan konkluzionet e auditimit, të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë projekt raport paraprak të auditimit.

Termat e auditimit janë parashikuar në planin e auditimit nr.8867/4, datë 02.06.2023 sipas Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.127 datë 29.05.2023 "Për angazhim auditimi", në Agjencinë e Trajtimit të Kredive.

Auditimi për veprimtarinë ATK-së iu nënshtrua periudhës nga 01 janar 2020 - 31 prill 2023. Auditimi u realizua në terren gjatë periudhës 05-23 qershor 2023.

Për zhvillimin e procesit është autorizuar grupi i punës i përbërë nga Z. , Z. dhe Z. anëtar. i përgjegjës grupi,

Projekt-raporti i auditimit është kthyer në drejtorinë e auditimit të brendshëm me shkresat nr.prot.12638/1 datë 21.07.2023 dhe 12638/2 datë 21.07.2023 me komentet dhe sqarimet përkatëse.

II. Metodatat e përdorura

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në varësi të fushës së audituar. Intervistimit, e leximit dhe studimit të raporteve, krahasimit, modelimit statistikor, ekzaminimi kryq etj.

III. Gjetjet e auditimit

Në vijim janë renditur gjetjet e auditimit në fushën e veprimtarisë të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, për periudhën e audituar.

MASA nr.1	
Lidhja me programin e auditimit.	I. Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm. 1. Mjedisi i kontrollit. 2. Menaxhimi i riskut. 3. Veprimtaritë e kontrollit. 4. Informacioni dhe komunikimi. 5. Monitorimi.
Gjetja	Kuadri procedural i funksionimit të brendshëm të ATK-së nuk është i harmonizuar me komponentët e legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Përshkrimi i gjetjes	Agjencia e Trajtimit të Kredive është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Financave, me seli në Tiranë. Agjencia ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8894 datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" dhe të legjislacionit në fuqi. Në zbatim të Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, u bë vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Agjencinë e Trajtimit të Kredive. 1. Mjedisi i kontrollit a) integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të agjencisë; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkia dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve. Kuadri ligjor i ATK-së, mbështetet në ligjin nr. 8894 datë 14.5.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar, VKM nr.681 datë 11.06.2009 e ndryshuar, Udhëzim nr.33 datë 24.09.2010 të Ministrit Financave si dhe akte të nxjerra nga organet drejtuese. Sipas ligjit organet drejtuese të ATK përbëhen nga; Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtoria me tre përfaqesues; Drejtori i Përgjithshëm dhe dy Zv/Drejtorë për të cilët lidhet kontratë çdo vit nga këshilli mbikëqyrës. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 anëtar nga të cilët njëri caktohet nga Banka e Shqipërisë, një tjetër nga Këshilli i Financave dhe tre nga anëtarët e tjerë caktohen nga

Këshilli i Ministrave. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen për një periudhë kohore 3 vjeçare.

Rregullorja e fundit e agjencisë është miratuar me vendimin e KM nr.67 datë 27.07.2018, e ndryshuar me vendimin nr.81 datë 01.10.2019 në të cilën përfshihen vetëm detyrat funksionale të pozicioneve të stafit të ATK-së.

ATK ka të miratuar me urdhër të Drejtorit Përgjithshëm nr.prot 7700 datë 16.12.2019 *"Rregulloren e parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në ATK"*.

Kjo rregullore në përmbajtjen e saj ka ligjin 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Rregullorja e funksionimit të brendshëm të ATK-së ka mungesa në:

- procedurat dhe afatet e komunikimit administrativ në nivel horizontal dhe vertikal të stafit.
- procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit të burimeve njerëzore të institucionit.
- rregullat dhe procedurat e veçanta të disiplinës në institucion.
- referencat e kuadrit ligjor/rregullativ të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe hartimit të buxhetit të agjencisë.

Këshilli Mbikëqyrës gjithashtu nuk ka miratuar rregulloren të funksionimit të tij.

Për mirëfunksionimin në vazhdimësi të veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës nevojitet hartimi i rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës e cila përcakton afatet, njoftimet, rendin e ditës, dokumentacionet që do të paraqiten në mbledhje etj.

Një bazë e mirë mbështetje për Këshillin Mbikëqyrës është dhe ligji nr.8480, date 27.5.1999 *"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"*.

ATK bazuar në nenin 10 nr. 8894 datë 14.5.2002 *"Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive"* i ndryshuar ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë;

- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shtator të vitit 2014,
- ALUIZNI në gusht 2015,
- Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në mars 2018.,
- Marrëveshje me Bankën e Shqipërisë në qershor 2020.

Marrëveshjet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve dhe shkëmbimin e shpejtë të informacionit të nevojshëm për ATK.

Sipas nenit 10 të ligjit kërkohet lidhja e marrëveshjeve edhe me institucionet e tjera si drejtoria e shërbimit të transportit rrugor, zyra të gjendjes civile, organet e pushtetit vendor, bankat të nivelit të dytë.

Struktura organizative dhe pagat e punonjësve për periudhën objekt auditimi janë miratuar me vendimet e mëposhtme të Këshillit Mbikëqyrës;

- vendim nr.81 datë 01.09.2019 me numër total punonjësish 27.
- vendim pa numër, datë 16.12.2021 me numër total punonjësish 28.
- vendim nr.2 datë 25.02.2022 është ndarë pozicioni specialistit burimeve njerëzore dhe sekretare e KM dhe DP, në 1 specialist BNJ dhe 1 sekretare e KM dhe DP, gjithashtu është suprimuar specialisti i parë i financës në specialist finance. Numër total punonjësish 29.
- vendim nr.15 datë 16.12.2022 është rivendosur pozicioni specialist i parë i financës dhe janë rritur pagat e punonjësve. Numri total i punonjësish është 29.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Sipas nenit 11/2 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, duhet të krijohet regjistri i riskut, vlerësimi dhe kontrolli i risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të drejtorisë.

Menaxhimi i riskut të institucionit është i rëndësishëm për arritjen e objektivave të Drejtorisë.

Ai ofron mbështetje dhe këshillim për organet drejtuese të njësisë dhe kujdeset për performancën e agjensisë.

Risqet duhet të identifikohen gjatë procesit të përgatitjes së programit buxhetor të agjensisë dhe analizave të vazhdueshme referuar misionit të agjensisë. Pas analizimit hartohet regjistri i risqeve, përgatitet plani i veprimit për minimizimin e tyre.

Rezulton se për periudhën objekt auditimi, nuk janë vlerësuar risqet që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive së agjensisë.

3. Aktivitetet e kontrollit

Njësitë e sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Referuar aktivitetit të Këshillit Mbikëqyrës;

Sipas nenit 14 të ligjit Këshilli i Mbikëqyrës i Agjencisë është përgjegjës për drejtimin e Agjencisë dhe përgjigjet para Këshillit të Ministrave.

Këshilli Mbikëqyrës raporton me shkrim çdo 6 muaj përpara Këshillit të Ministrave.

Referuar komunikimit me agjensinë rezulton se nuk ka raportime të këshilli mbikëqyrës të ATK-së në Këshillin e Ministrave.

Vendimmarrja e këshillit mbikëqyrës për vitet 2021-2022:

Viti 2021

Njoftime, Mbledhje/ Rendi i ditës dhe PV i mbledhjes	Vendim i KM Objekti i vendimit	Materiale bashkëngjitur, komente
26.01.2021; diskutime nga drejtoria	Nr.103 datë 26.01.2023 rilidhje e kontratës DP të agjensisë	Relacion i DP, kontrata
26.02.2021; diskutime nga drejtoria, leje vjetore DP	-	-
-	Nr.104 datë 24.03.2023 Miratim dorëheqje ZV/përgjithshëm	
29.03.2021; diskutime nga drejtoria, rilidhje e kontratës	Nr.105 datë 29.03.2021 rilidhje e kontratës DP të agjensisë	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor kontrata
29.04.2021; diskutime nga drejtoria, bilanci financiar 2020, ecuria ekonomike	Nr.106 datë 29.04.2021 Miratimi bilancit kontabël 2020 dhe autorizimi i auditimit PF	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor, bilanci kontabël.
31.05.2021; diskutime nga drejtoria	Nr.107 datë 29.04.2021 lidhje e kontratës ZV/DP të agjensisë	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor, Nuk është bashkëngjitur dosja me dokumentacion dhe CV e kandidatit për ZV/Përgjithshëm
30.06.2021; diskutime nga drejtoria, shesë buxheti për shpenzime qira dhe transferimin e zyrave dhe magazinës nga ish-zyra rajonale Tiranë në Kavajë. Leje vjetore Zv/DP	Datë 30.06.2021 Dhënie leje Zv/DP	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor
29.07.2021; diskutime nga drejtoria,	Datë 02.08.2021	Relacion i DP Raporti statistikor mujor

shtesë buxheti për shpenzime qira dhe transferimin e zyrave dhe magazinës nga ish-zyra rajonale Tiranë në Kavajë. Leje vjetore DP të agjencisë.	Miratim dorëheqje Zv/Dp të agjencisë	
31.08.2021 diskutime nga drejtorja,	-	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
30.09.2021 diskutime nga drejtorja	-	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
29.10.2021 diskutime nga drejtorja	Datë 01.11.2021 Dhënie leje DP.	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
26.11.2021 diskutime nga drejtorja	-	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
16.12.2021 Ndryshim i strukturës organizative për vitin 2022	6386/5 datë 28.12.2021 për strukturën	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
Dhënie leje ZV/DP	6386/7 datë 28.12.2021 Për dhënie leje	
28.12.2021 Projektbuxheti i vitit 2022, Plani i veprimtimit 2022, Shpërblimet e punonjësve dhe KM,	Datë 28.12.2021 për miratimin e buxhetit agjencisë plani 90 milion lekë dhe shpenzime operative 51,783 lekë. Vendim nr.prot 64/58 datë 28.12.2021 për shpërblim të punonjësve dhe KM.	Plani veprimtimit 2022, Relacion mbi buxhetin e shpenzimeve 2022 nga DP, Tabelat sipas natyrë shpenzimeve.

Për vitin 2021 janë kryer 14 mbledhje të këshillit mbikëqyrës;

Janë marrë 8 vendime për lidhjen e kontratave të punës me anëtarët e drejtorisë dhe dhënien e leje.

1 vendim për miratimin e bilancit kontabël 2020.

1 vendim për miratimin e strukturës agjencisë.

1 vendim për miratimin e buxhetit agjencisë.

1 vendim për shpërblim të punonjësve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Viti 2022

Njoftime, Mbledhje/ Rendi i ditës dhe PV i mbledhjes	Vendim i KM Objekti i vendimit	Materiale bashkëngjitur, komente
18.01.2022; diskutime nga drejtoria	Nr.1 datë 18.01.2022 rilidhje e kontratës DP të agjensisë	Relacion i DP, kontrata
25.02.2022; - diskutime nga drejtoria - diskutime nga drejtoria, shtesë buxheti për shpenzime qira dhe transferimin e zyrave në masën 17,955 mijë lek. - ndryshimi i strukturës	Nr.2 datë 25.02.2022 Miratim i shtesës në strukturë. Nr.3 datë 25.02.2022 Miratim i shtesës në buxhet në masën 17,955 mijë lek.	Relacion i DP -për ndryshimet strukturore dhe shtesën e buxhetit dhe ndryshimet në buxhet.
30.03.2022; - diskutime nga drejtoria -të ndryshme - rilidhje e kontratës Zv/DP	Nr.4 datë 30.03.2022 Miratim dorëheqje ZV/përgjithshëm	Relacion i DP, kontrata
28.04.2022; -diskutime nga drejtoria, bilanci financiar 2021, ecuria ekonomike, -ofertat e marrjes me qera të ambienteve	-Nuk ka vendim dhe arsyet nuk është diskutuar bilanci!	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor, Nuk është bashkëngjitur bilanci kontabël me PF. - PV i mbledhjes.
30.05.2022; -diskutime nga drejtoria -diskutim për kriteret e zgjedhjes audituesit, -diskutim mbi zhvendosjen e ambienteve sipas VKM nr.49 date 26.01.2022	-	-
22.06.2022; diskutime nga drejtoria, -treguesit ekonomik- financiar dhe bilanci i agjensisë 2021 -ndryshim zëri shpenzimesh, -Leje vjetore ZV/DP të agjensisë.	-Nr.5 datë 22.06.2022 Miratim i bilancit kontabël 2021 -Nr.6 ndryshim zëri shpenzimesh -Nr.7 datë 22.06.2022 Dhënie leje ZV/DP	Relacione të DP, Raporti statistikor mujor PV të mbledhjes
30.08.2022 diskutime nga drejtoria,	Nr. 9 datë 30.08.2022	Relacion i DP Raporti statistikor mujor

-rilidhje kontrate Zv/DP	Rilidhje kontrate	kontrata
29.09.2022 diskutime nga drejtoria	Nr.10 datë 29.09.2022 Dhënie leje DP	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
datë 12.10.2022 diskutime nga drejtoria	Nr.11 datë 12.10.2022 Miratim dorëheqje ZV/DP	Relacion i DP Raporti statistikor mujor
datë 12.10.2022 diskutime nga drejtoria. Dhënie leje ZV/DP	Nr.13 datë 31.10.2022 Dhënie leje ZV/DP.	
30.11.2022 diskutime nga drejtoria diskutimi i buxhetit 2023 -ritja e pagave të agjencisë -	Nr.14 datë 30.11.2022 Miratim i rritjes pagave punonjësve dhe KM.	Procesverbal. Relacion.
diskutime nga drejtoria -Miratimi i strukturës organizative -Miratimi i buxhetit	-Nr.15 datë 16.12.2022 Miratimi i strukturës organizative. -Nr.16 datë 30.12.2022 Miratimi i buxhetit 2023 -Nr.17 datë 30.12.2022 Miratim dhënie bonusi	Relacion i DP Raporti statistikor mujor

Për vitin 2022 janë kryer 14 mbledhje të këshillit mbikëqyrës;

Janë marrë 7 vendime për lidhjen e kontratave të punës me anëtarët e drejtorisë, miratimin e dorëheqjeve dhe dhënien e leje.
 2 vendime për miratimin e shtesave në strukturë.
 1 vendim për miratimin e shtesës në buxhet
 1 vendim për miratimin e bilancit kontabël 2021.
 1 vendim për ndryshim zëri shpenzimesh.
 1 vendim për miratimin e buxhetit agjencisë 2023.
 1 vendim për rritje pagash.
 1 vendim për shpërbllim të punonjësve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 anëtar nga të cilët njëri caktohet nga Banka e Shqipërisë, një tjetër nga Këshilli i Financave dhe tre nga anëtarët e tjerë caktohen nga Këshilli i Ministrave. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen për një periudhë kohore 3 vjeçare.

Këshilli Mbikëqyrës aktualisht rezulton me një vakancë, përfaqësues të Këshillit të Ministrave.

Kryetari i KM përfaqësues i MFE-së ka ndryshuar dhe është emëruar me urdhërin e Ministrit Financave dhe Ekonomisë nr.75 datë 24.02.2022.

Në referencë të nenit 12 të ligjit për ATK-në për anëtarëve të këshillit mbikëqyrës përfaqësues të Këshillit të Ministrave dhe Bankës së Shqipërisë, ju ka mbaruar mandati 3-vjeçar.

Ligji i ATK-së konkretisht nenet 15,16,17,21 ka përcaktuar drejtorinë e përgjithshme si ushtruese të funksioneve për veprimtarinë e agjencisë për detyrat dhe kompetencat që i ngarkon këshilli mbikëqyrës.

Në rregulloren e miratuar të institucionit kompetencat e anëtarëve të drejtorisë (drejtor dhe 2 zv/drejtor) nuk janë të përcaktuara qartë. Drejtoria ka funksionuar pa një kuadër procedural të mirëpërcaktuar.

-Zv/drejtorat e agjencisë përcaktohet në rregullore që varen nga drejtori i përgjithshëm, ndërsa referuar ligjit anëtarët e drejtorisë ku përfshihen dhe zv/drejtorat janë në varësi dhe raportojnë tek këshilli mbikëqyrës.

Për anëtarët e drejtorisë janë lidhur kontrata pune 1-vjeçare nga këshilli mbikëqyrës.

Baza ligjore e agjencisë nuk ka ndryshuar për periudhën objekt auditimi, më hollësisht kjo çështje do të analizohet në pikat e programit më poshtë.

4. Informimi dhe komunikimi

Komunikimi me strukturat e tjera të administratës dhe palët e treta ka qenë i drejtpërdrejtë, me postë elektronike dhe zyrtarisht në formë shkresore për informacionet hyrëse dhe dalëse.

Me shkresën nr.12/4 datë 24.12.2019 është relatuar këshillit mbikëqyrës plani i veprimit 2020 i agjencisë ku është paraqitur gjëndja e debitorëve dhe problematikat e mëposhtme në mbledhjen e debisë si;

-Adresat e debitorëve

-Pezullimi i veorimeve përmbartimore pasi ka debitorë të larguar jashtë vendit

-Vlera e kolateralit të lënë garanci është më e ulët se shpenzimet për ankandin dhe shpenzimet përmbartimore.

-Mosha e debitorëve një pjesë e madhe janë në pension

-Mungesë të dhënash në dokumentacionin e kredisë.

-Debitorët që kanë ndërruar jetë, duhet çelja e trshgimisë proces me kosto të larta

-Janë evidentuar 75 sh.p.k me vlerë principali 293 milion lekë, pa status aktiv, duhet drejtuar gjykatës për shpallje falimenti dhe caktim likuidatori, process që ka kosto.

-Në ekzekutim të detyrueshëm në shërbimin përmbartimor privat janë 1892 dosje me vlerë principali 2,177,178,887 lekë dhe 50 dosje në përmbartimin shtetëror me vlerë 23,446,433 lekë.

Me shkresën nr.12/4 datë 24.12.2020 është relatuar këshillit mbikëqyrës plani i veprimit 2021 i agjencisë ku është paraqitur gjëndja e debitorëve, trajtimi ligjor, sektori i riskut dhe ankandet, marrëveshjet institucionale.

	Me shkresën nr.6458/2 datë 28.12.2021 është relatuar këshillit mbikëqyrës plani i veprimit 2022 i agjencisë ku është paraqitur gjëndja e debitorëve, trajtimi ligjor, sektori i riskut dhe ankandet, marrëveshjet institucionale. Me shkresën nr.145 datë 13.01.2023 është relatuar këshillit mbikëqyrës plani i veprimit 2023 i agjencisë ku është paraqitur problematikat dhe zgjidhja, treguesit e arkëtimeve dhe performancës, trajtimi ligjor, sektori i riskut dhe ankandet, marrëveshjet institucionale. Janë kryer raportimet në ministrinë e financave dhe ekonomisë për çdo vit. 5. Monitorimi Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohet, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit agjencisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se, aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin është ngritur kjo drejtori. Funksionin e monitorimit e kryen drejtoria e agjencisë dhe këshilli mbikëqyrës sipas kompetencave. Monitorimin e kryen edhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë sipas ligjit nëpërmjet strukturave përkatëse si njësi e auditimit të brendshëm.
Baza rregullatore	Në zbatim të Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive “, i ndryshuar” Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore.
Problematika e konstatuar	Kuadri procedural i funksionimit të brendshëm të ATK-së nuk është i harmonizuar me komponentët e legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Ka pasur lëvizje të shpeshta të stafit të cilat kanë ndikuar vazhdimësinë e punës së institucionit proces që rrit riskun e proceseve të punës së agjencisë.
Impakti i gjetjes	Risk për cënimin e aktiviteteve , rezultateve dhe efektivitetit të punës agjencisë.
	<u>Rekomandimi nr.1 i lënë në projekt-raport.</u> Të merren masa për plotësimin e kuadrit rregullator të funksionimit të agjencisë sipas legjislacionit në fuqi të institucioneve publike në aspektet e; -procedurave dhe afatet e komunikimit administrativ në nivel horizontal dhe vertikal të stafit. -rregullat e sjelljes dhe kodin e etikës së institucionit. -rregullat dhe procedurat e veçanta të disiplinës në institucion. -referencat e kuadrit ligjor/rregullativ të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Koment nga pala e audituar	ATK vepron në përputhje me ligjin nr. 8894 datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive “, i ndryshuar”. Në rregulloren e brendshme nr.ptor.9/8 datë 01.10.2019 janë të përcaktuara përgjegjësitë e gjithësecilit, procedurat dhe afatet e komunikimit. -Në kontratën individuale të punës janë të cituar baza ligjore si kodi i punës, masat disiplinore, ligji për rregullat e etikës në administratën publike. -Lëvizjet e stafit kanë qënë të argumentuara dhe arsyetuara, ka pasur shkak ligjor, lëvizjet gjithashtu kanë qënë në kuadër të rritjes aspektit profesional. -Përsa i përket trajnimeve ATK nuk ka një fond të akorduar për trajnime pasi nuk janë nëpunës civil. Stafi ka kryer trajnime për mbrojtjen e të dhënave, dekalrimin e pasurisë, përdorimin e sistemit HRMIS, trajnimi i punonjësve të arkivës. Në vijim do bashkëpunohet me DAP që stafi të angazhohet në trajnime.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	-Në raport grupi i auditimit ka konstatuar që rregullorja ka të përcaktuara detyrat funksionale të punonjësve të saj, por nuk është e harmonizuar sipas komponentëve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin. -Pavarsisht se në misionin e rregullores përcaktohet që veprimtaria bazohet në ligjin e etikës dhe kodin e punës etj, në brendësi të saj duhen detajuar procedurat. -Ndër të tjera si e kemi sqaruar në raport rregullorja duhet përditësuar dhe harmonizuar me legjislacionin në fuqi, për ta konkretizuar në rregullore përcaktohet që administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave monetare dhe materiale bëhet sipas ligjit nr. 6942 datë 25.12.1984 dhe VKM-së nr.70 datë 11.03.1985, këto akte ligjore janë shfuqizuar prej shumë vitesh. -Në raport grupi i auditimit ka konstatuar që dokumentacioni dhe dosjet e punonjësve janë të rregullta dhe nuk është relatuar që janë bërë lëvizje të parregullta apo emërimet tilla. Qëllimi i këtij konkluzioni siç është trajtuar në raport është për analizimin nga ana e ATK të lëvizjeve të shpeshta, uljen e këtij risku dhe vënien në vend të politikave të ndryshme të burimeve për mbajtjen e stafit duke pasur parasysh specifikat e institucionit. <u>Rekomandimi nr.1 riformulohet në planin e veprimit përfundimtar si më poshtë:</u>
Rekomandim nr. 1	Agjencia të përditësojë rregulloren e funksionimit të saj sipas komponentëve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
Risku	I Lartë

	<u>Rekomandimi nr.2 i lënë në projekt-raport.</u> Të administrohen nga agjencia vendimet e emërimeve apo rimeërimeve të antërave të këshillit mbikëqyrës nga organi përgjegjës sipas ligjit.
Koment nga pala e audituar	ATK disponon vendimet e emërimeve dhe lirimeve nga detyra të kryetarëve dhe antëtarëve të këshillit mbikëqyrës. ATK nuk disponon shkresat e rimeërimeve apo rikonfirmimeve në detyrë të anëtarëve, pasi nuk janë dërguar nga organet përgjegjëse sipas ligjit çdo 3 vjet.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	-Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi vetëm shkresa e ndryshimit të kryetarit të këshillit mbikëqyrës. Me vënien në dispozicion të dokumentacionit të plotë për periudhat rezulton; -Anëtari nga organi përgjegjës i Bankës Shqipërisë është emëruar sipas shkrësës nr.prot. 7062 datë 11.05.2015 (protokolluar në MFE), nuk ka pasur rimeërimit pas përfundimit të afatit 3-vjeçar sipas ligjit për ATK-në. -Anëtarët e Këshillit të Ministrave janë emëruar në detyrë sipas vendimit nr.29 datë 22.01.2014 të Këshillit të Ministrave nga të cilët; Për 3 anëtarë të këshillit nuk ka pasur rimeërimit pas përfundimit të afatit 3-vjeçar sipas ligjit për ATK-në, 1 prej anëtarëve ka dhënë dorëheqjen sipas kërkesës së datës 10.04.2022. -Me shkresën nr.prot.4596 datë 18.07.2018 të agjencisë është njoftuar MFE për përfundimin e mandatit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. <u>Rekomandimi nr.2 riformulohet në planin e veprimit përfundimtar si më poshtë:</u>
Rekomandim nr. 2	Agjencia të ndërpresë menjëherë shpërblimin për anëtarët e këshillit mbikëqyrës të cilëve u ka përfunduar afati i emërimit nga organi përgjegjës.
Risku	I lartë
Rekomandim nr. 3	Këshilli mbikëqyrës të raportojë me shkrim përpara Këshillit të Ministrave mbi veprimtarinë e agjencisë sipas kërkesave të ligjit.
Risku	I mesëm

MASA nr.3

Lidhja me programin e auditimit.	II. Auditimi i Përputhshmërisë në aspektet; 1. Planifikimi i treguesve të kredisë, respektimi procedurave për ndjekjen e kredive. Zbatimi i procedurave dhe bazës ligjore për kolateralet e kaluara në pronësi të ATK-së dhe procedurat e shitjes së tyre. 2. Ndjekja e arkëtimit të tyre, vlerësimi i procedurave për vjeljen e kredisë me masa shtrënguese. Zbatimi i procedurave për ristrukturimet e detyrimit të debitorëve. 3.Saktësia dhe plotësia e dokumentimit të dosjeve të kredive, inventarizimi i tyre, përditësimi dhe arkivimi i dosjeve të kredive të mbyllura.										
Gjetja	<u>Referuar ndjekjes së debitorëve dhe suksesit të arktëtimeve për vitet 2020-2022:</u> Janë arkëtuar nga debitorët për llogari të ATK-së 152,158,420 lekë ose 88.9 %. Janë arkëtuar nga përmbaruesit privat për llogari të ATK-së 17,838,991 lekë ose 10.4 %. Janë arkëtuar nga përmbaruesit shtetëror për llogari të ATK-së 1,213,286 lekë ose 0,7 %. -Janë kryer pagesa nga agjencia pa pasur në dispozicion dokumentacion justifikues në shumën 3,907,305 lekë për shpenzimet e administrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit. - Janë kryer pagesa nga agjencia për tarifat e kalimeve të pronësisë mbi tarifën e përcaktuar të udhëzimit në total me diferencë 799,585 lekë. Referuar pasurive të paluajtshme të marra në kalim pronësie nga përmbaruesit gjyqësor privat për 10 prona cituar më lart nuk ka certifikatë pronësie bashkëlidhur dhe nuk janë regjistruar në kontabilitet për secilin debitor. Nuk ka procedura të mëtejshme të ndjekura për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë.										
Përshkrimi i gjetjes	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për periudhën objekt auditimi të dhënat për debitorët e mbyllur; <u>Debitorët e mbyllur 01/01/2020-30/04/2023</u> <table><tr><th>Viti</th><th>Nr i debitorëve të mbyllur</th><th>Principali i transferuar nga banka</th><th>Shpenzim e Gjyqi, tarifa</th><th>Shuma 000/lekë</th></tr><tr><td>2020</td><td>72</td><td>50,286</td><td>1,259</td><td>51,545</td></tr></table>	Viti	Nr i debitorëve të mbyllur	Principali i transferuar nga banka	Shpenzim e Gjyqi, tarifa	Shuma 000/lekë	2020	72	50,286	1,259	51,545
Viti	Nr i debitorëve të mbyllur	Principali i transferuar nga banka	Shpenzim e Gjyqi, tarifa	Shuma 000/lekë							
2020	72	50,286	1,259	51,545							

2021	119	87,584	2,751	90,335
2022	129	60,286	2,010	62,296
2023(Janar-Prill)	88	30,921	858	31,779
Totali	408	229,077	6,878	235,955

Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare (bilancet), situata e kredise në fund të vitit 2022 paraqitet:

Kategoria e huasë	Gjendja e portofolit të huasë		Zvogëlimi i gjendjes	
	Gjendja e trashëguar nga fillimi	Gjendja e mbetur 31.12.2022	Nga arketimet e ATK	Likujduar sipas ligjit
Principal të humbura	19,937,310,000	7,046,888	12,066,425,112	7,863,838,000
Interesa të humbura	15,718,548,000	8,856,555	14,098,505,445	1,611,186,000
Totali	35,655,858,000	15,903,443	26,164,930,557	9,475,024,000
Totali nr.debitorë ve	18,969	10,907	7,955	107
Ligji 9239 date 10/06/2004		84	Nderrmarje Shteterore	
VKM Nr 869 date 14/12/2011		23	Nderrmarje Shteterore	

Në Bankën e Shqipërisë janë hedhur në Sistemin Live të BSH 3,640 debitorë. Lista me këta debitorë të cilët janë hedhur në këtë sistem del automatikisht në të gjitha Bankat e Nivelit të Dytë dhe kjo bën të mundur pengesën e debitorëve të ATK-së për të marrë kredi tjetër. Ata nuk mund të marrin kredi në banka të tjera pa mbyllur më parë kreditinë me ATK-në, pasi në çdo bankë këta debitorë rezultojnë me status 4 (debitorë të këqinj). Çdo muaj hiqet nga kjo listë çdo debitor i cili mbyll detyrimin.

Kjo marrëveshje ka pasur rezultate positive në rritjen e arkëtimeve nga debitorët.

Sipas të dhënave të mësipërme konstatohet se nga huatë e ngelura për trajtim sipas fashave sipas shumave të kredive dhe kolaterale të përkatëse rezultojnë në total 9 fasha si më poshtë:

1. Fasha 0-30,000 Lekë
Ka në total 3,738 debitorë dhe nga këta 3,712 debitorë janë pa kolaterale.
2. Fasha 30,000-100,000 Lekë
Ka në total 719 debitorë dhe nga këta 352 debitorë janë pa kolaterale.
3. Fasha 100,000-500,000 Lekë
Ka në total 2,962 debitorë dhe nga këta 760 debitorë janë pa kolaterale.
4. Fasha 500,000-1,000,000 Lekë
Ka në total 1,268 debitorë dhe nga këta 242 debitorë janë pa kolaterale.
5. Fasha 1,000,000-5,000,000 Lekë
Ka në total 1,073 debitorë dhe nga këta 100 debitorë janë pa kolaterale.
6. Fasha 5,000,000-10,000,000 Lekë
Ka në total 45 debitorë dhe nga këta 5 debitorë janë pa kolaterale.
7. Fasha mbi 10,000,000 Lekë
Ka në total 45 debitorë dhe nga këta 5 debitorë janë pa kolaterale.
8. Fasha mbi EURO
Ka në total 283 debitorë dhe nga këta 27 debitorë janë pa kolaterale.
9. Fasha mbi USD
Ka në total 688 debitorë dhe nga këta 244 debitorë janë pa kolaterale.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga agjensia rezultojnë për ndjekje 1228 dosje në zyrat e përmbarimit gjyqësor privat dhe 185 dosje në zyrat e përmbarimit shtetëror.

-Nga verifikimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezulton se ATK-ja ka në regjistër 77 pasuri të paluajtshme gjëndje të sekuestruara.

-Gjithashtu ATK ka 5 pasuri të luajtshme automjete, traktora, të lëna në ruajtje tek debitorët. Automjetet janë verifikuar së fundmi nga ATK, të cilat kryesisht janë të amortizuara të vitit të prodhimit 1992. Nuk ka pasur procedura të mëtejshme për trajtimin e tyre.

Gjatë periudhës janë arkëtuar detyrimet për 1 pasuri të cilat janë shitur me ankand.

Ankandet për pronat e konfiskuara në pronësi të ATK janë zhvilluar disa herë por suksesi në shitjen e tyre rezulton shumë i ulët.

Arsyet e mos shitjes së pronave janë të ndryshme dhe rast pas rasti. Disa nga arsyet janë largësia e pronave që shfaqin pak interes për blerësit, toka bujqësore në zona të thella, fshatra të largët, apo ndërtesa të amortizuara. Pronat janë marrë në pronësi të ATK-së vit pas viti pas përfundimit të procedurave të ankandit publik dhe mosshitjes së tyre.

Sipas të dhënave të administruara ATK ka ndarë zonat në të gjithë Shqipërinë sipas qarqeve, çdo jurist ka për detyrë ndjekjen e debitorëve sipas zonave që ka në

përgjegjësi. Në tabelën e mëposhtme paraqitet i gjithë portofoli me debitorët e ATK-së i ndarë sipas qarqeve. Gjithashtu në këtë tabelë është bërë dhe kategorizimi i dosjeve sipas urdhërave të ekzekutimit.

Për arkëtimet e detyrimeve me anë të zyrave përmbartimore dokumenti kryesor për fillimin e procesit ekzekutimit është urdhëri ekzekutimit të lëshuar nga gjykatat e vendit.

Zona	Portofoli i ATK					
	Kukës	Tropojë	Has	Dibër	Bulqizë	Total
Debitorë total	1002	573	349	425	53	2402
UE origjinal	254	75	34	52	14	429
Ue Fotokopje	417	195	241	177	26	1056
Ue të pa lëshuar ose pa info	331	303	74	196	13	917

Zona	Portofoli i ATK			
	Tiranë	Durrës	Kavajë	Total
Debitorë total	283	135	56	474
UE origjinal	10	15	0	25
Ue Fotokopje	195	100	25	320
Ue të pa lëshuar ose pa info	78	20	31	129

Zona	Portofoli i ATK				
	Krujë	Lezhë	Mirditë	Mat	Total
Debitorë total	930	824	361	435	2550
UE origjinal	395	96	33	88	612
Ue Fotokopje	513	101	237	228	1079
Ue të pa lëshuar ose pa info	22	627	91	119	859

Zona	Portofoli i ATK				
	Malësi e Madhe	Shkoder	Puke	Lac	Total
Debitorë total	780	825	292	213	2110
UE origjinal	83	167	92	44	386
Ue Fotokopje	231	356	127	126	840
Ue të pa lëshuar ose pa info	466	302	73	43	884

Portofoli i ATK						
Zona	Lushnje	Berat	Kucovë	Mallakastër	Skrapar	Total
Debitorë total	461	114	22	71	128	796
UE origjinal	15	14	6	6	23	64
Ue Fotokopje	405	97	12	60	86	660
Ue të pa lëshuar ose pa info	41	3	4	5	19	72

Portofoli i ATK									
Zona	Korçë	Ersek	Devol I	Pograd	Librazhd	Elbasan	Gramsh	Pegim	Total
Debitorë total	179	138	11	227	70	463	134	52	1274
UE origjinal	20	15	0	22	7	15	10	4	93
Ue Fotokopje	113	98	11	101	32	220	71	28	674
Ue të pa lëshuar ose pa info	46	25	0	104	31	228	53	20	507

	Total
Debitorë total	10782
UE origjinal	1809
Ue Fotokopje	5427
Ue të pa lëshuar ose pa info	3546

Aktualisht janë në ndjekje 10782 debitorë nga të cilët 1809 prej tyre kanë urdhra ekzekutimi origjinal, 5427 kanë urdhra ekzekutimi dublikatë dhe 3546 prej tyre nuk kanë të lëshuar urdhëra ekzekutimi ose nuk ka informacion.

Arkëtimet e realizuara sipas viteve.

ARKETIME 2020							
Lek			Ark. nga komisio n	Euro		Usd	
P.Privat	P.Shteteror	nga debitorët		P.Privat	debitorët	Permbarues Privat	debitorët
5,894,375	249,950	29,542,232	12,861	-	61,074	7,550	61,544
					Kursi= 123.7	Kursi= 100.84	Kursi= 100.84

					7,554,853	761,342	6,206,096
Total	50,221,709						

ARKETIME 2021

LEK					Euro	USD
P.Privat	P.Shtetëror	debitorët	komisi o	Ankand	debitorët	debitorët
6,504,298	266,003	42,550,948	8,500	15,450,000	50,621	53,070
					Kursi= 120.76	Kursi= 106.54
					6,112,991 lek	5,654,077 lek
Total	76,546,817					

ARKETIME 2022

Lek				Euro		USD	
P.Privat	P.Shtetëror	debitorët	komisi	debitorët	P.Privat	debitorët	P.Privat
4,501,952	697,333	45,282,241	11,505	42,235	800	41,387	800
				Kursi= 114.23		Kursi= 107.05	
				5,738,436 lek		5,286,891 lek	
Total	61,518,358						

Referuar ndjekjes së debitorëve dhe suksesit të arktëtimeve për vitet 2020-2022:

Janë arkëtuar nga debitorët për llogari të ATK-së 152,158,420 lekë ose 88.9 %.

Janë arkëtuar nga përmblyesit privat për llogari të ATK-së 17,838,991 lekë ose 10.4 %.

Janë arkëtuar nga përmblyesit shtetëror për llogari të ATK-së 1,213,286 lekë ose 0,7 %.

Për periudhën objekt auditimi 2020-2023 është bërë kalimi i pronësisë nga përmblyesit tek ATK për pronat e mëposhtme;

Debitori	Vlera në kontabilitet	Veprimet Përmblyimore dokumentacioni bashkëngjitur dhe	Vlera që duhet paguar për shërbimin përmblyor
Ndertese 99 m2	1,389,000 lek	-Vendim për kalim pronësie datë 30.10.2018, -Çmim i ankandit 2-të 1,389,000 lekë, -P.V kalim sendi ATK datë 10.03.2020,	91,674 lekë

	Përmet		-Ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur -Urdhër për regjistrim kontabilitet nr.4542 datë 18.07.2019, -Depozitim fature e përmbaruesit datë 11.03.2020. -Paguat FTSH nr.64 datë 11.03.2020 në vlerën 142,680 lekë me TVSH.	
	“Arë” me sip.3500m ² , Selenicë-Vlorë	490,000 Lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 14.09.2016. - Vlera e ankandit të dytë 490,000 lekë. - P.V kalim sendi ATK-së, dt. 09.01.2021 - Ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nr.1465 prot., datë 15.02.2021. - Depozitim fature e përmbaruesit datë 15.02.2021. - Fatura tatimore me nr.02.. datë 09.02.2021 me vlerën 36,000 lekë me TVSH.	36,000 lekë e rregullt
	“Truall” me sip.300m ² , Kalivaç-Tepelenë	1,280,000 lekë ose 10,422.60 (Euro) sipas kursit ditor të BSH-së 122,81	- Vendim për kalim pronësie datë 11.07.2013. - Vlera e ankandit të dytë 1,280,000 lekë. - Proces verbal kalim sendi ATK-së, 02.03.2020. -Ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. -Urdhër për regjistrim në kontabilitet Nr.1518 prot., datë 05.03.2020. -Depozitim fature e përmbaruesit, datë 03.02.2021. -Faturë tatimore me nr.58, datë 02.03.2020 me vlerë 153,600 lekë me TVSH.	84,480 lekë
	“Arë” me sip. 14,100 m ² , Kalivaç - Tepelenë	1,804,000 lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 11.07.2013. - Vlera e ankandit të dytë 1,804.000 lekë. - Proces verbal kalim sendi ATK-së, 04.02.2021. -Nuk ka çertifikatë pronësie . -Nuk ka urdhër për regjistrim në kontabilitet . -Depozitim fature e përmbaruesit, datë 03.02.2021. -Faturë tatimore me nr.92, datë 03.02.2021 me vlerë 216,576 lekë me TVSH. Likujduar 217,076.00 datë 05.02.2021	119,064 lekë
	“Truall” me	2,248,646 lekë	-Vendim për kalim pronësie datë 14.09.2016. -Vlera e ankandit të dytë 2,248,646 lekë. -P.verbal për kalim sendi sendi ATK-së, 05.11.2020. - Ka çertifikatë bashkëlidhur praktika.	103,887 lekë

	sip.1930,5 m2-Arshi Lengo- Gjirokastrë		- Urdhër për regjistrimin në kontabilitet Nr.4092 prot., datë 05.11.2020. -Depozitim fature e përmbauesit 04.11.2020. -Faturë tatimore me nr. 74, datë 04.11.2020, me vlerën 215,869 lekë me TVSH.	
		1,408,000 lekë	-Vendim për kalim pronësie datë 25.02.2013. -Vlera e ankandit të dytë 1,408,000 lekë. -P.verbal për kalim sendi sendi ATK-së, 04.11.2020. - Ka çertifikatë pronësie me sipërfaqe 4000 m2.	92,928 lekë
	(prona 1) "Tokë Arë" me sip.8400 m2, Dragot Tepelenë	192,000 lekë	- Urdhër për regjistrimin në kontabilitet Nr. 4532 prot., datë 18.12.2020. -Depozitim fature e përmbauesit 04.11.2020. -Faturë tatimore me nr. 75, datë 04.11.2020, me vlerën 195,840 lekë me TVSH (për të dyja pronat).	
	(prona 2) "Tokë Arë" me sip.1200m 2, Dragot Tepelenë		-Vendim për kalim pronësie datë 25.02.2013. -Vlera e ankandit të dytë 192,000 lekë. -P.verbal për kalim sendi sendi ATK-së, 04.11.2020. - Ka çertifikatë bashkëlidhur praktika - Urdhër për regjistrimin në kontabilitet Nr.4532 prot., datë 18.12.2020. -Depozitim fature e përmbauesit 04.11.2020. -Faturë tatimore (shih pronat).	21,600 lekë
	Ndërtesë, 81m2, Hekal, Mallakastër	930,352 lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 29.04.2016. - Vlera e ankandit të dytë 930,352 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt. 09.02.2021. - Ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nr. 4398 prot., datë 28.06.2016. - Depozitim fature e përmbauesit datë 09.02.2021. - Fatura tatimore me nr.94., datë 09.02.2021 me vlerën 111,642 lekë me TVSH.	61,403 lekë
	Truall+ndërtesë, sip 53m, trualli 185 m2	256,000 lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 23.11.2012. - Vlera e ankandit të dytë 256,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, (Nuk ka). - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka.	26,400 lekë E rregullt

Referuar komunikimit me agjensinë rezulton se nuk ka raportime të këshilli mbikëqyrës të ATK-së në Këshillin e Ministrave.

Vendimmarrja e këshillit mbikëqyrës për vitet 2021-2022:

Viti 2021

Njoftime, Mbledhje/ Rendi i ditës dhe PV i mbledhjes	Vendim i KM Objekti i vendimit	Materiale bashkëngjitur, komente
26.01.2021; diskutime nga drejtoria	Nr.103 datë 26.01.2023 rilidhje e kontratës DP të agjensisë	Relacion i DP, kontrata
26.02.2021; diskutime nga drejtoria, leje vjetore DP	-	-
-	Nr.104 datë 24.03.2023 Miratim dorëheqje ZV/përgjithshëm	
29.03.2021; diskutime nga drejtoria, rilidhje e kontratës	Nr.105 datë 29.03.2021 rilidhje e kontratës DP të agjensisë	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor kontrata
29.04.2021; diskutime nga drejtoria, bilanci financiar 2020, ecuria ekonomike	Nr.106 datë 29.04.2021 Miratimi bilancit kontabël 2020 dhe autorizimi i auditimit PF	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor, bilanci kontabël.
31.05.2021; diskutime nga drejtoria	Nr.107 datë 29.04.2021 lidhje e kontratës ZV/DP të agjensisë	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor, Nuk është bashkëngjitur dosja me dokumentacion dhe CV e kandidatit për ZV/Përgjithshëm
30.06.2021; diskutime nga drejtoria, shtesë buxheti për shpenzime qira dhe transferimin e zyrave dhe magazinës nga ish-zyra rajonale Tiranë në Kavajë. Leje vjetore Zv/DP	Datë 30.06.2021 Dhënie leje Zv/DP	Relacion i DP, Raporti statistikor mujor
29.07.2021; diskutime nga drejtoria,	Datë 02.08.2021	Relacion i DP Raporti statistikor mujor

	Krahës-Tepelenë		- Depozitim fature e përmbaresit datë 31.03.2021. - Fatura tatimore me nr. 17., datë 31.03.2021 me vlerën 26,400 lekë me TVSH.	
	“shtëpi banimi”, Delisuf-Vlorë	840,000 lekë	-Vendim për kalim pronësie datë 29.04.2016. - Vlera e ankandit të dytë 840,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.31.03.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka. - Depozitim fature e përmbaresit datë 31.03.2021. - Fatura tatimore me nr. 18., datë 31.03.2021 me vlerën 100,800 lekë me TVSH.	55,440 lekë
	“Depo farnash”, 267m2, Krahës-Tepelenë	800,000 lekë	-Vendim për kalim pronësie datë 23.11.2012. - Vlera e ankandit të dytë 800,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.10.02.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka. - Depozitim fature e përmbaresit datë 10.02.2021. - Fatura tatimore me nr. 03., datë 10.02.2021 me vlerën 96,000 lekë me TVSH.	52,800 lekë
	“Are+Trua II”, Panahor-Mallakastër, sip.300m2	1,472,000 lekë	-Vendim për kalim pronësie datë 19.11.2013. - Vlera e ankandit të dytë 1,472,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.09.02.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka. - Depozitim fature e përmbaresit datë 29.02.2021. - <u>Paguar Fatura tatimore me nr. 1., datë 09.02.2021 me vlerën 176,640 lekë me TVSH.</u>	97,152 lekë
	Truall-“Livadhja”-Sarandë 250m2	1,536,000	-Vendim për kalim pronësie datë 10.02.2014. - Vlera e ankandit të dytë 1,536,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.03.02.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka. - Depozitim fature e përmbaresit datë 03.02.2021. - <u>Paguar Fatura tatimore me nr. 93., datë 03.02.2021 me vlerën 184,320 lekë me TVSH.</u>	101,376 lekë

Gjirokastrë -Arë, sip 600m², -Arë me sip.3600m² 2-Arë me sip.2250m² "Ndërtesë" 195,6m² në Këlcyrë "shtëpi banimi", Hekal-Mallakastër Kalivac-Tepelenë. Truall me sip.300m²	134,400 lekë 832,000 lekë 448,000 lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 29.05.2014. - Vlera e ankandit të dytë për të tria pronat: 134,400 lekë, 832,000 lekë, 448,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.25.02.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, ka. - Depozitim fature e përmbauesit datë 25.02.2021. - Fatura tatimore me nr. 6, datë 25.02.2021 me vlerën (26,400+99,840,+36,000)= 162,240 lekë me TVSH.	1. 20,400 lekë 2. 54,912 lekë 3. 33,600 lekë
	734,106 lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 16.01.2012. - Vlera e ankandit të dytë 734,106 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.29.02.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, ka. - Depozitim fature e përmbauesit datë 25.02.2021. - Fatura tatimore me nr. 5, datë 24.02.2021 me vlerën = 88,092 lekë me TVSH.	48,450 lekë
	96,000 lekë	- Vendim për kalim pronësie datë 25.06.2014. - Vlera e ankandit të dytë 96,000 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.31.03.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka. - Depozitim fature e përmbauesit datë 31.03.2021. - Fatura tatimore me nr. 16, datë 31.03.2021 me vlerën = 18,000 lekë me TVSH.	18,000 lekë e rregullt
	89,600 lekë	-Vendim për kalim pronësie datë 19.11.2013. - Vlera e ankandit të dytë 89,600 lekë. - P.Verbal kalim sendi ATK-së, dt.12.02.2021. - Nuk ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur praktika. - Urdhër për regjistrim në kontabilitet, nuk ka. - Depozitim fature e përmbauesit datë 11.02.2021. - Fatura tatimore me nr. 04, datë 11.02.2021 me vlerën = 10,752 lekë me TVSH.	16,800 lekë
Referuar pasurive të paluajtshme të marra në kalim pronësie nga përmbauesit gjyqësor privat për 10 prona cituar më lart nuk ka ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur dhe nuk			

janë regjistruar në kontabilitet për secilin debitor. Nuk ka procedura të mëtejshme të ndjekura për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë.

	Pagesa përmbaruesit privat për tarifën e kalimit pronësisë	Tarifat që duheshin aplikuar
Total	1,935,951	1,136,366
Diferenca e mbipaguar total	799,585 lekë	

Referuar udhëzimit të përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017 i ndryshuar me udhëzimin e përbashkët nr.30 datë 30.08.2018;

Pika 3b;

Për lirim dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përlllogaritet në masën e 2 pagave bazë minimale mujore, kur sendi nuk ka një vlerë monetare të përcaktuar për çmimin e shitjes sipas të dhënave nga regjistri i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo sipas vlerësimit të një eksperti të pavarur të caktuar nga gjykata dhe/ose përmbaruesi gjyqësor privat. Në rast se sendi i paluajtshëm ka një vlerë referuese për çmimin e shitjes së tij sipas të dhënave të zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo sipas vlerësimit të ekspertit, atëherë tarifa fikse përlllogaritet në përqindje mbi vlerën e sendit, sipas tabelës së treguar në pikën 2 të këtij seksioni.

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000
150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1% Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë

- Me shkresën e përmbauesit gjyqësor datë 07.04.2020 është depozituar FTSH nr.65 datë 07.04.2020 në vlerën 1,857,895 me TVSH për shpenzimet përmbaimore për 38 debitor të listuar. Bashkëlidhur ndodhet tabela me 38 debitor në të cilën është kërkuar 48,892 lek me tvsh shpenzimet e administrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e veprimeve përmbaimore të pezulluara për secilën praktikë.

Fatura e mësipërme është likuaduar në 3 pjesë sipas urdhrave nr.1783/1 datë 09.04.2020 dhe transfertës datë 10.04.2020 në vlerën 850,000 lekë, nr.prot.1860 datë 28.04.2020 dhe transfertës datë 28.04.2020 në vlerën 500,000 lekë, nr.prot.1903 datë 13.05.2020 dhe transfertës datë 13.05.2020 në vlerën 507,896 lekë.

- Me shkresën e përmbauesit gjyqësor nr.prot.3295 datë 08.09.2020 është depozituar FTSH nr.72 datë 08.09.2020 në vlerën 1,680,000 me TVSH për shpenzimet përmbaimore për 35 debitor të listuar. Bashkëlidhur ndodhet tabela me 35 debitor në të cilën është kërkuar 48,000 lek me tvsh shpenzimet e administrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e veprimeve përmbaimore të pezulluara për secilën praktikë.

Bashkëngjitur ndodhen 35 procesvebale të përmbauesit secili në vlerën 48,000 lek me tvsh ku sqarohet se shpenzimet përmbaimore përfshijnë;

- shpenzimet për administrimin e të dhënave të dosjes
- shpenzimet operative (administrative, logjistik, furnizime zyre) në masën 15 %.
- shpenzimet e hulumtimit për pasuri të palës debitor.
- shpenzime mbi komunikimin e akteve etj.

Fatura e mësipërme është likuaduar në 2 pjesë sipas urdhrave nr.3469 datë 15.09.2020 dhe transfertës datë 15.09.2020 në vlerën 840,000 lekë, nr.prot.3576 datë 24.09.2020 dhe transfertës datë 24.09.2020 në vlerën 840,000 lekë.

- Me shkresën e përmbauesit gjyqësor nr.prot.2829 datë 12.05.2021 janë depozituar faturat e thjeshta tatimore të shitjes nr.11,12,13,14 datë 12.05.2021 në total në vlerën 369,200 lekë për shpenzimet përmbaimore për 43 debitor të listuar. Bashkëlidhur ndodhet tabela me 43 debitor në të cilën janë kërkuar shpenzimet e administrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e veprimeve përmbaimore të pezulluara për secilën praktikë.

Agjencia ka pasur praktika të tjera të ngjashme për pushimin e ekzekutimit dhe heqjen dorë nga përmbauesit për të cialt nuk janë paguar tarifa administrimi si më lart, konkretisht;

- ✓ Me shkresën nr.prot.760 datë 28.01.2021 nga ATK është kërkuar heqja dorë nga ekzekutimi zyrës përmbaimore për 43 praktika dosjesh. Me procesverbalin e datës 29.01.2021 i janë dorëzuar përfaqësuesve të ATK-së 43 dosje me dokumentacionin përkatës dhe nuk janë tarifuar shpenzime administrimi nga zyra përmbaimore.

- ✓ Me shkresën nr.3449 datë 18.05.2023 nga ATK është kërkuar heqja dorë nga ekzekutimi zyrës përmbaimore për 1 praktikë debitor. Me vendimin e pushimit të përmbauesit nr.3449/1 datë 26.05.2023 është ndërprerë ekzekutimi dhe është dërguar dokumentacioni i dosjes ATK-së. Nuk janë tarifuar shpenzime administrimi nga zyra përmbaimore.

Referuar kreut IV Pika 1 e udhëzimit të përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017 i ndryshuar përcaktohet:

Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke përfshirë shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;

- a) Shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përmbaimore;
- b) Shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin dhe ruajtjen e sendeve të sekuestruara ose pasurisë së sekuestruar;
- c) Shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;
- d) Shpenzimet në lidhje me caktimin e përfaqësuesit ligjor të palës debitor, shpenzimet e kryera për veçimin e pjesës takuese të palës debitor dhe shpenzimet për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së palës debitor;
- e) Shpenzime në lidhje me publikimin e ankandit;
- f) Shpenzimet e kryera për dorëzimin e barrës/ve sigurorese;
- g) Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përmbaues (brenda tarifave të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve), me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, me objekt kundërshtim veprimesh përmbaimore dhe pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë konstatohet pavlefshmëria e veprimeve

	përmbardimore për shkak zbatimi gabim apo moszbatim të ligjit nga përmbarduesi gjyqësor privat, ky i fundit nuk mund të faturojë shpenzimin te kreditori. Nëse këto shpenzime janë parapaguar nga kreditori, subjekti përmbardues do t'ia rikthejë ato kreditorit; h) Shpenzimet për veprimet procedurale pranë Zyrtarëve të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas tarifave zyrtare të miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme." <u>Referuar kreut IV Pika 4 dhe 5 e udhëzimit të sipërcituar:</u> Për shpenzimet e parashikuara në pikën 1 të këtij seksioni, subjekti përmbardues lëshon faturë tatimore ndaj palëve kreditore apo debitore, e cila shoqërohet me kopje të <u>dokumenteve të pagesave të lëshuara nga të tretët, dokumente të cilat shërbejnë për të dokumentuar shpenzimet e zbritshme të subjektit përmbardues, sipas legjislacionit në fuqi</u>". Shpenzimet përmbardimore të pagueshme nga subjekti përmbardues dhe të kryera në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas masës dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi, përpara përfundimit të ekzekutimit, përshkruhen në një akt përmbledhës, të emërtuar "Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit", duke bashkëlidhur faturat përkatëse. Pala debitore së cilës i ngarkohen këto shpenzime, ka të drejtë të njihet dhe të marrë kopje të këtij procesverbali." Referuar udhëzimit të përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017, i ndryshuar përmbarduesit privat nuk ka vënë të mësipërm nuk kanë vënë në dispozicion faturat tatimore përkatëse të pagesave të lëshuara nga të tretët për të justifikuar faturën e lëshuar për shpenzimet e administrimit sipas kreut 4 pika 4 e udhëzimit. Këto shpenzime nuk janë përshkruar me procesverbalin për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit si kërkesë e pikës 5 të këtij kreu. Faturat e mësipërme të paguara nga ATK nuk janë paguar në përputhje me legjislacionin.
Baza rregullatore	-Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive ", i ndryshuar". -VKM nr.681, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive ", të ndryshuar. -Udhëzim nr.33, datë 24.9.2010 "Për trajtimin e kredive të transferuara etj". -Udhëzimi i përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017 i ndryshuar me udhëzimin e përbashkët nr.30 datë 30.08.2018.
Problematika e konstatuar	Referuar pasurive të paluajtshme të marra në kalim pronësie nga përmbarduesit gjyqësor privat për 10 prona cituar më lart nuk ka ka çertifikatë pronësie bashkëlidhur dhe nuk janë regjistruar në kontabilitet për secilin debitor. Nuk ka procedura të mëtejshme të ndjekura për nxjerrjen e çertifikatave të pronësisë.

	-Në kundërshtim me udhëzimi i përbashkët të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë Drejtësisë nr.385/7 datë 28.06.2017 i ndryshuar me udhëzimin e përbashkët nr.30 datë 30.08.2018 janë kryer pagesa si më poshtë; -Janë kryer pagesa të pajustificuara në vlerën 3,907,305 lekë për shpenzimet e administrimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit. - Për tarifën e kalimeve të pronësisë janë kryer pagesa për përmbartues gjyqësor privat mbi tarifën e përcaktuar të udhëzimit në total me diferencë 799,585 lekë.
Impakti i gjetjes	Pagesa të pajustificuara me dokumentacion provues ligjor. Mosndjekje e procedurave për regjistrimin e pasurive të kaluara në favor të ATK-së.
Risku	I lartë
Rekomandim nr. 4	Për të rritur efektivitetin dhe arkëtimet e detyrimeve të debitorëve, përmirësimin e politikave dhe masat e ndjekura nga ATK rekomandojmë: a) Të kërkohej informacion për ecurinë e procesit të ekzekutimit nga të gjitha zyrat përmbartimore që kanë lidhur kontratë shërbimi me ATK-në dhe të marrë masa për vazhdimin e procesit të ekzekutimit. b) Për të gjitha rastet e mungesës së administrimit të urdhër ekzekutimit të leshuar nga gjykata, të kërkohej në gjykate urdhërat e ekzekutimit duplikatë dhe të vijojë procesin e ekzekutimit të detyrimit.
Koment nga pala e audituar	Nga ana institucionit ka pasur verifikime të vazhdueshme për ecurinë e procedurave dhe korrespondimin e tyre me fazat e evidentuara në dosjet e debitorëve. ATK ka ngritur dhe një grup pune me zgjedhje për verifikimin e procedurave përmbartimore. Ky rekomandim është ndjekur vazhdimisht. Vetëm gjatë këtij 6-mujori janë të evidentuara 150 raste të reja dërgimi për ekzekutim si dhe 50 raste lëshim dublikate. ZP shtetërore dhe private me ATK-në kanë një bashkëpunim prej më shumë se 2 dekadash. Për të mos pasur vonesa në pagesa dhe realizimin e targetit të arkëtimeve gjatë kontaktit edhe të debitorëve që kanë qenë në ekzekutim u është bërë me dije që detyrimin ta mbyllin në ATK dhe pjesën takuese tek debitori.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	Të dhënat e paraqitura nga ana juaj janë vlerësuar me zgjedhje nga grupi i auditimit edhe grupet e punës të ngritura për ndjekjen e debitorëve. Të dhënat e vëna në dispozicion nga ana juaj për statusin aktual të ndjekjes debitorëve (të cilat ndryshojnë në vazhdimësi sipas ecurisë rezultojnë për ndjekje 1228 dosje në zyrat e përmbartimit gjyqësor privat dhe 185 dosje në zyrat e përmbartimit shtetëror. Gjithashtu sipas të dhënave tuaja janë në ndjekje 10782 debitorë nga të cilët 1809 prej tyre kanë urdhra ekzekutimi origjinal, 5427 kanë urdhra ekzekutimi dublikatë dhe 3546 prej tyre nuk kanë të lëshuar urdhëra ekzekutimi ose nuk ka informacion sipas të dhënave të vëna në dispozicion.

	Ky rekomandim është lënë në dobishmëri edhe referuar kapaciteteve të burimeve që ATK ka në dispozicion, që procesi të ecë paralelisht me ndjekjen nëpërmjet procedurave përmbartimore dhe plotësimin e dosjeve me UE. Përsa i përket të dhënave të ndjekjes së debitorëve dhe të arktëtimeve për vitet 2020-2022 grupi auditimit është referuar të dhënave sipas derdhjeve dhe mandateve të kryera në llogarinë e ATK-së dhe sipas regjistrimeve në pasqyrat financiare, çka nuk kundërshton faktin se një pjesë e tyre mund të jenë si pasojë e veprimeve përmbartimore. <u>Rekomandimi nuk ndryshon.</u>
	<u>Rekomandim nr. 5,6,7 i të lëna në projekt raport.</u> Agjencia të ndjekë rrugët ligjore për kthimin e pagesave të pajustificuara sipas faturës tatimore shitje nr.65 datë 07.04.2020 dhe faturë tatimore shitje nr.72 datë 08.09.2020 në shumën 3,537,895 lekë me TVSH, faturuar për shpenzimet e administrimit për kryerjen e procedurave përmbartimore. Agjencia të ndjekë rrugët ligjore për kthimin e pagesës së pajustificuara faturave të thjeshta tatimore nr.11,12,13,14 datë 12.05.2021 në total në shumën 369,200 lekë, faturuar për shpenzimet e administrimit për kryerjen e procedurave përmbartimore. Të ndiqen rrugët ligjore për kthimin e diferencave të faturuara më shumë nga përmbartuesit gjyqësor privat sesa tarifat e procedurave të kalimeve të pronësisë në masën 799,585 lekë.
Koment nga pala e audituar	Vëmë në dukje se rekomandimet 5,6,7 janë në trajtim nga ana jonë duke kërkuar sqarime të më të hollësishme mbi procedurën e ndjekur. Për rekomandimin nr.5; Sipas kreut 7 pika c e udhëzimit të përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017, të gjitha pagesat e bëra nga ana e institucionit për zyrën përmbartimore janë tarifa që i faturohen debitorit në momentin e likuidimit të detyrimit dhe përsëri janë të kthyshme në llogari të institucionit. Për rekomandimin nr.6; Jemi në të njëjtën situatë si me rekomandimin nr.5. Presim përgjigje me email nga përmbartuesja. Për rekomandimin nr.7 Mes përmbartuesve gjyqësor dhe ATK-së është lidhur kontratë shërbimi tip.

	Përsa u përket pagesave të kryera e cila duhet të ishte në shumën 1,136,366 lekë dhe jo 1,935,951 lekë me një diferencë prej 799,858 lekë sqarojmë se pagesa është kryer konformë procedurave të cilat kanë qënë në fuqi. Përmbaruesi është bazuar në udhëzimin e përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017 dhe direktivës nr.551 datë 20.12.2018 të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyësor Privat. Sa më sipër rezulton dhe shkresa sqaruese e Ministrisë së Drejtësisë nr.prot.413/2 datë 04.02.2019 që konfirmon këtë qëndrim. Udhëzimi i përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017 ka qënë në fuqi deri në datën 01.12.2022 kur ka përfunduar gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës Lartë. Shtesa e faturuar prej 799,585 lekë nuk qëndron dhe llogaritja është bërë në bazë të kuadrit ligjor në fuqi. Marrëdhëniet me palën kreditore rregullohen me anë të kontratës së shërbimit. Në kontratën e shërbimit janë specifikuar tarifat e shërbimit përmbarimor të cilat nuk parapagohen. Është tagër dhe e drejtë e palës debitore të kundërshtojë veprimet përmbarimore.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	Grupi i auditimit nuk komenton dhe nuk ka relatuar çështje midis marrëdhënies kontraktuale të institucionit dhe përmbaruesve gjyqësor, si një proces normal për misionin që kanë të dy palët. Problematika e sqaruar në raport rezulton mbi faktin se; -ATK nuk ka kryer kontrollin e shpenzimit për faturat që i janë lëshuar por ka proceduar vijimin e pagesës. -Përpara miratimit të pagesës strukturat përgjegjëse kanë detyrimin të kryejnë kontrollin formal/ligjor të shpenzimit duke e krahasuar me bazën ligjore në fuqi, bazuar në dokumentacionin justifikues. Grupi i auditimit nuk merr përsipër të komentojë vendimet e gjykatave mbi vlefshmërinë juridike të Udhëzimit të përbashkët nr.385/7 datë 28.06.2017 i ndryshuar me udhëzimin e përbashkët nr.30 datë 30.08.2018. Në rast se ka paqartësi në interpretimin e vendimeve gjyqësore të kërkohet interpretimi sipas legjislacionit në fuqi.

	Në vijim referojmë se udhëzimi i përbashkët nr. 30, datë 30.8.2018, për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017, “për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”, të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave ka qënë objekt gjyqësor dhe është pezulluar zbatimi i tij me vendimin e Gjykatës Administrative e Apelit nr.363 datë 26.09.2018. -Në vijim po kjo gjykatë me vendim përfundimtar themeli nr.211 datë 17.12.2018 ka hequr masën e sigurimit dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë. Pra nga data 17.12.2018 e në vazhdim ndryshimi i udhëzimit ka qënë në fuqi. -Kjo është rikonfirmuar edhe me vendimin e Gjykatës Lartë nr.00-2022-3236 datë 01.12.2022 mbi fuqinë juridike të udhëzimit. Gjithashtu Gjykata e Lartë me vendimin nr.00-2022-3624 datë 01.12.2022 ka gjykuar çështjen në themel dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.211 datë 17.12.2018 të Gjykatës Administrative e Apelit. Në rast se ka paqartësi në interpretimin e vendimeve gjyqësore të kërkohet interpretimi sipas legjislacionit në fuqi. <u>Rekomandimet 5,6,7 riformulohen në planin e veprimit përfundimtar si më poshtë:</u>
Rekomandim nr. 5	Agjencia të kërkojë justifikimin e pagesave të kryera për shpenzimet e administrimit për kryerjen e procedurave përmbartimore dhe në rast mosvënje në dispozicion të dokumentacionit të ndjekë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumave; 1. Sipas faturave tatimore shitje nr.65 datë 07.04.2020 dhe nr.72 datë 08.09.2020 në shumën 3,537,895 lekë me TVSH. 2. Sipas të faturave të thjeshta tatimore nr.11,12,13,14 datë 12.05.2021 në shumën 369,200 lekë.
Rekomandim nr.6	Agjencia të ndjekë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e mbifaturimit të paguar për tarifat e procedurave të kalimeve të pronësisë në shumën 799,585 lekë.
Rekomandim nr. 7	Të ndiqen procedurat për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë për pasuritë e paluajtshme të marra në kalim pronësie nga përmbartuesit gjyqësor privat.
Koment nga pala e audituar	Praktikat e evidentuara janë analizuar dhe janë bërë aplikime ndër vite, por ka mungesë përgjigje nga ASHK-të respektive. (bashkëlidhur praktikat për 10 debitorët). Në vijim do të vepohet sipas procedurës lidhur me nxjerrjen e certifikatave të pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	Praktikat shkresore dhe komunikimet ndër vite 2012-2021 me ZVRPP-të dhe ASHK-në të vëna në dispozicion nga ana juaj janë parë disa me zgjedhje nga grupi i auditimit. Është i nevojshëm që komunikimi të vijojë deri për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë dhe më pas regjistrimin e vlerës në kontabilitetin e ATK-së. <u>Rekomandimi nuk ndryshon.</u>

	Rekomandim nr. 9 i lënë në projekt-raportin e auditimit; Për debitorin të bëhen verifikimet dhe sistemimet e nevojshme për diferencën që paraqet certifikata e pronësisë prej 4000 m2 tokë arë krahasuar me procedurat e ndjekura nga përmbartuesi dhe ATK në të cilën kjo pasuri cilësohet 8400 m2 tokë arë.
Koment nga pala e audituar	Është bërë lapsus nga ana e ATK-së kur janë nxjerrë urdhërat e brendshëm për kontabilizimin e pronave dhe pagesën e përmbartuesit gjyqësor. Shkresa për dorëzim-lirim sendi dhe fatura janë bërë për 4000 m2 dhe jo për 8400 m2.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana juaj, certifikata e pronësisë dhe regjistrimi në kontabilitet ky rekomandim hiqet dhe nuk vendoset në planin e veprimit përfundimtar.

MASA nr.4	
III. Auditimi financiar.	
Lidhja me programin e auditimit.	1. Zbatimi i rregullave për planifikimin e burimeve dhe përdorimin e tyre, respektimi i limiteve sipas zërave të planifikuar, vlerësimi i aktivitetit të shpenzimeve, miratimi dhe raportimi në organin drejtues. Rakordimi dhe derdhja e të ardhurave nga arkëtimet e kredive. 2. Zbatimi i rregullave në fushën e pagave dhe shpërblimeve (procesi nga emërimi/kontraktimi, caktimi i pagës dhe përputhje saj me vendin e punës, saktësia e llogaritjeve, derdhja e detyrimeve fiskale etj.)
Gjetja	Raporti i shpenzimeve të kryera ndaj arkëtimeve të realizuara është në masën: 73,7 %, për vitin 2020; 50,51 % për vitin 2021; 72,9 % për vitin 2022 nga 25% që është kufiri ligjor i shpenzimeve. Mangësi në vendosjen e procedurave dhe afateve të planit buxhetor. Agjensia nuk i ka përcaktuar në rregullore procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore, si procedurat e shpalljes, emërimit/largimit të stafit. - Pozicionet e lira të punës në agjensi janë shpallur në faqen zyrtare të internetit të institucionit, por nuk është kërkuar të shpallen në Portalin Kombëtar të Punësimit”, apo në forma të tjera të informimit të publikut, për të garantuar vizibilitet dhe konkurrencë në përthithjen e stafit.

Përshkrimi i gjetjes

Për vitin 2020: Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.86, datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të agjencisë të trajtimit të kredive për vitin 2020”, janë miratuar struktura, arkëtimet dhe shpenzimet për vitin 2020, të Arkëtimet, në shumën 80.000 mijë lekë dhe shpenzimet 49,645 mijë lekë, numri i punonjësve 27.

Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.93, datë 27.05.2020, është miratuar shtesë fondi, në shumë 100 mijë lekë, shpenzime për Covid -19. Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.96, datë 26.08.2020, është miratuar shtesë fondi, në shumë 45 mijë lekë, shpenzime për Sanitare me kohë të pjesshme. Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.96, datë 26.08.2020, është miratuar shtesë fondi, në shumë 45 mijë lekë, shpenzime për Sanitare me kohë të pjesshme. Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.101, datë 29.10.2020, është miratuar shtesë fondi, në shumë 45 mijë lekë, shpenzime për Sanitare me kohë të pjesshme. (3-mujore). Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.100, datë 29.10.2020, është miratuar shtesë fondi, në shumë 250 mijë lekë, shpenzime për Zërin Dieta.

Për vitin 2021: Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.106, datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të agjencisë të trajtimit të kredive për vitin 2021”, janë miratuar struktura, arkëtimet dhe shpenzimet për vitin 2021, Arkëtimet, në shumën 90.000 mijë lekë dhe shpenzimet 50,604 mijë lekë, numri i punonjësve 27.

Për vitin 2022: Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.6458/4, datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të agjencisë të trajtimit të kredive për vitin 2022”, janë miratuar struktura, arkëtimet dhe shpenzimet për vitin 2022, Arkëtimet, në shumën 90.000 mijë lekë dhe shpenzimet 51,783 mijë lekë, numri i punonjësve 28.

Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.3, datë 25.02.2022, është miratuar shtesë fondi, në shumë 17,955 mijë lekë. Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, nr.6, datë 22.06.2022, është bërë ndryshim në shpenzime “Shërbime mirëmbajtje pajisje elektronike nga 500 mijë lekë, në 200 mijë lekë dhe shtim “Blerje Fotokopje dhe Printeri”, 300 mijë lekë.

Referuar urdhërit të Ministrit MFE-së nr.75 datë 24.02.2022 kryetari i Këshillit Mbikqyrës është ndryshuar.

Mbledhjet dhe vendimet e datës 25.02.2022 janë organizuar pasi është ndryshuar kryetari i Këshillit Mbikqyrës.

Për vitin 2023: Me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.16, datë 30.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të agjencisë të trajtimit të kredive për vitin 2023”, janë miratuar struktura, arkëtimet dhe shpenzimet për vitin 2022, Arkëtimet, në shumën 90.000 mijë lekë dhe shpenzimet 57,139 mijë lekë, numri i punonjësve 29.

Plani i Shpenzimeve

Në 000 lekë

Vitet	Plani fillestar	Shtesa	Pakësime	Plani Përf.
2020	49,645	440	0	50,085

2021	50,604	0	0	50,604
2022	51,783	17,955	0	69,738
2023	57,139	0	0	57,137

Realizimi i Arkëtimeve

Në 000 lekë

2020		2021		2022		4-mujori	2023
Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
80,000	50,817	90,000	77,643	90,000	60,180	90,000	25,849

• Për vitin 2020, Arkëtimet janë realizuar në shumën 50,817 mijë lekë, nga 80,000 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 63,5 %, pra më pakë nga planifikimi për 29,183 mijë lekë.

• Për vitin 2021, Arkëtimet janë realizuar në shumën 77,643 mijë lekë, nga 90,000 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 86 %, pra më pakë nga planifikimi për 12,357 mijë lekë.

• Për vitin 2022, Arkëtimet janë realizuar në shumën 60,180 mijë lekë, nga 90,000 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 66,9 %, pra më pakë nga planifikimi për 29,820 mijë lekë.

• Për periudhën 4-mujore 2023, Arkëtimet janë realizuar në shumën 25,849 mijë lekë ose në masën 28,7 %, e planit vjetor.

Nga auditimi i shpenzimeve të ushtrimit për vitet në auditim dhe krahasimi me shpenzimet e realizuara në vitet e mëparshme rezultojnë;

Arkëtimet dhe shpenzimet

Në 000/ lekë

Emërtimi	2020	2021	2022	Plani 2023
Arkëtime	50,817	77,643	60,180	90,000
Te ardhura te tjera	0.361	-	10,625	-
Shpenzime	37,475	39,218	43,901	57,139
Shpenzime Financiare KFË	59,277	55,327	66,236	-
Raporti shpenzime aktiviteti/ të ardhurat të realizuara	73.7%	50.51%	72.9%	63.48%
<u>Nga këto:</u> Shpenzime pesoneli	24,619	26,438	25,712	32,000
Shpenzime te tjera	12,856	12,779	18,189	25,139

Rap.shpenz.perso nel/shpenzime te tjera	66/34	67/33	59/41	56/44
---	-------	-------	-------	-------

Ne bilancin e vitit 2020 dhe 2021 jane hequr pagat e Këshillit Mbikqyrës që ishin të përfshirë në bilanc te shpenzime personeli.

Viti 2020: 1,852,223 leke

Viti 2021: 2,320,032 leke

Raporti i shpenzimeve të kryera ndaj arkëtimeve të realizuara është në masën: 73,7 %, për vitin 2020; 50,51 % për vitin 2021; 72,9 % për vitin 2022 dhe 63,48 % për vitin 2023 (planifikimi) nga 25% që është kufiri ligjor i shpenzimeve.

Trendi i rënies së arkëtimeve dhe i rritjes së shpenzimeve vazhdon edhe për 4/mujorin e parë të vitit 2023.

Nga analiza e treguesve financiarë me treguesit e tyre në 3 vitet e fundit rezulton se; Treguesit financiar të arkëtimeve kanë patur rënie nga viti në vit, ndërsa rritja e shpenzimeve ka vazhduar çdo vit në raport të zhdrejtë me realizimin e të ardhurave.

Treguesit financiarë dhe të punës janë raportuar dhe analizuar periodikisht çdo muaj si dhe vjetor. Me poshtë jepen disa tregues të llogaritur mbi pasqyrat financiare.

Kostot e ATK për 3 vitet e fundit krahasuar me arkëtimet jepen si më poshtë;

Treguesit financiar të arkëtimeve dhe Shpenzimeve

Në 000 lekë				
Vitet	Arkëtime	Kosto gjithsej	Raporti	Efektet negative të rap. Ardh plan/shpenz
1	2	3	4=3/2 x 100	5
2020	50,817	37,475	73.7%	+24,771
2021	77,643	39,218	50.51%	+19,807
2022	60,180	43,901	72.9%	+28,856
Buxheti 2023	90,000	57,139	63.48%	+34,639

Rritja e shpenzimeve në krahasim me arkëtimet, ka sjellë një gjëndje të rëndë financiare të ATK e cila karakterizohet nga paafësia paguese e saj duke rritur detyrimet çdo vit.

-Zbatimi i rregullave në fushën e pagave dhe shpërblimeve (procesi nga emërimi/kontraktimi, caktimi i pagës dhe përputhje saj me vendin e punës, saktësia e llogaritjeve, derdhja e detyrimeve fiskale etj.)

Marrëdhëniet në fushën e punës dhe të pagave janë rregulluar referuar ligjit: 7961, datë 12.07.1995 «Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë». Ligjit 8894, datë 14.05.2020 «Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive dhe ligjit, nr.9131 datë 08.09.2003 «Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike».

- Pozicionet e lira të punës në agjensi janë shpallur në faqen zyrtare të internetit të institucionit, por nuk është kërkuar të shpallen në Portalin Kombëtar të Punësimit”, apo në forma të tjera të informimit të publikut, për të garantuar vizibilitet dhe konkurrencë në përthithjen e stafit.
- Kriteret të përgjithshme apo të veçanta të pozicioneve të punës në agjensi janë vendosur në shpalljen e faqes zyrtare të agjensisë, si arsimimi, eksperiencia, kriteret të veçanta aftësish, çertifikata të nevojshme etj.

Referuar lëvizjeve të stafit për periudhën objekt auditimi:

Emertimi	Ndryshimet e stafit gjatë viteve Janar 2020-prill 2023							
	2020		2021		2022		-Maj 2023	
	largim	emerim	largim	emerim	largim	emerim	largim	emerim
Dr. Përgjith.								
Zv/drejtor.	1	1	2	2	1	1		
Spec/BNJ/ Sek DP Sek/K.M		2						
Spec/BNJ/ Sek DP Sek/K.M								
Përgj/Sek/ Jur/Opera			2					
Speci/Jurist Opera	2	1	3		3	5	1	
Spec.Jurist Arketimesh	1							
Përgj/Sek/ Fin	1	1			1	1		
Speci/Fin i pare								
Specia/ Finan							1	1
Përgj/Sekt/ Risku	1	1	1					
Specialist Risku		1	2	3	3	5		
Përgj/Shërb.			1					
Special/It dhe statistike	1	1						
Magazinjier dhe mirembajtes								

Arkivist dhe Protokollues		1	2	2				
Arkivist								
Protokollues						1	1	
Shofer			2	1	1	1		
Receptionist				1			1	1
Sanitare				1				
Gjithsej	7	9	15	10	9	14	4	2
Emerime 2020-05.2023	35 emërimë gjithësej të stafit.							
Largime 2020-05.2023	35 largime gjithësej të stafit nga të cilët 32 me dorëheqje dhe 3 me masë disiplinore							

Lëvizje të brendshme të stafit të ATK-së, (ndryshime pozicionesh)

Ndryshim pozicioni 2020	Ishte	Bëhet
O.C.	Spec.Brnj/Sek.Drejt./Sek.KM	Prgj.Sek.Mbeshtetes
E.M.	Spec.Risku	Spec.Jurist dhe Opera.
F.LI.	Spec. BRNJ / Sek.Drejtori	Spec.Risku
E.C.	Spec.Juridik dhe Opera.	Spec.Risku
E.C.	Spec.Risku	Spec.Bnj dhe As.Drejtori
M.K.	Prgj.Sherbimeve Mbesht.	Prgj. Sek.Juridik dhe Opera.
D.K.	Arkiv Protokoll	Spec.Menaxhim Risku
Gjithësej	7 lëvizje të brendshme të stafit	

Ndryshim pozicioni 2021	Ishte	Bëhet
	Spec. Risku	Spec. Jurist dhe Ope.
	Spec.Risku	Spec.Finance
	Spec.Finance	Pergj. Risku
	Spec.Jurist Arketimesh	Spec.Jurist dhe Opera.
	Reception	Magazine dhe mirembajtje
	Magazinier	Shofer
	Spec.Jurist dhe arketimesh	Prgj.Sek.Juridik dhe Oper.
Gjithësej	7 lëvizje të brendshme të stafit	

Ndryshim pozicioni 2022	Ishte	Bëhet
	Spec.Risku	Spec.Jurist
	Spec.Risku	Spec.Jurist
	Spec.Jurist	Prgj.Sekt.Mbeshtetes
	Arkiv-Protokoll	Spec.Finance
	Spec.Finance	Spec. Risku
	Spec. Finance	Spec. Jurist
	Spec. Jurist	Prgj.Sekt. Riskut
	Spec. Jurist	Spec.BNj./Asistente
	Prgj.Sekt. Riskut	Spec. Finance
Gjithësej	9 lëvizje të brendshme të stafit	

Ndryshim pozicioni 2023	Ishte	Bëhet
	Spec.Risku	Spec. BNj
	Spec.Risku	Spec.Jurist
	Spec.BNj./Asistente	Asist.Drejtori/K.Mbik.
	Spec.BNj./Asistente	Spec. Risku
Gjithësej	4 lëvizje të brendshme të stafit	

Për periudhën objekt auditimi 2020-prill 2023 ka pasur 27 ndryshime pozicionesh pune të stafit të ATK-së.

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dosjeve të personelit rezulton;

- Dosjet e punonjësve janë të plota dhe kanë bashkëngjitur dokumentacionin përkatës sipas kodit të punës;
- Përsa i përket përshkrimeve të punës së punonjësve janë hartuar dhe miratuar për çdo pozicion pune me detyrat kryesore dhe teknike të stafit.
- Për sa i përket vlerësimeve mbi performancën e punës së stafit, rezultoi se është kryer mbi bazën e një formatit tip të agjensisë.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave, për periudhën objekt auditimi, rezultoi sa vijon:

Nivelet e pagave janë përcaktuar në Vendimet e Këshillit Mbikqyrës, dhe konkretisht, për vitin 2020, me vendimin nr.86, datë 24.12.2019, për vitin 2021, me vendimin nr.102, datë 29.12.2020, për vitin 2022 me vendimin nr.6458/4, datë 28.12.2021 dhe për vitin 2023 me vendimin nr.16, datë 30.12.2022.

Proçesi i emërimeve të punonjësve është kryer duke lidhur kontratë individuale midis drejtorit përgjithshëm të ATK-së dhe punonjësit.

Nga auditimi i 10 dosjeve të personelit, rezultoi se: janë plotësuar konformë dispozitave ligjore në fuqi me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm: Diplomë, Listë notash, vërtetimin të gjendjes Gjyqsore, Raport mjekësor, kontratë individuale e punës etj.

Nga auditimi i Listë Pagesave u evidentua dhe konstatua që:

- ✓ Përmbledhja e listë pagesave që shoqëron Transaksionin Bankar për Shpenzimin e pagave është nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues, Nëpunësi Autorizues dhe Specialisti i Financës, punonjësi i caktuar për pagat.
- ✓ Të gjitha detyrimet e Institucionit për pagesën e pagave të punonjësve janë paguar vetëm nga llogaria e Institucionit, nga personat e autorizuar.

Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për llogaritjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat.

Realizimi i “Fondi i Pagave” dhe “Sigurime shoqërore & shëndetësore”, për periudhën objekt auditimi paraqitet:

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore

në 000leke

	Buxheti 2020		Buxheti 2021		Buxheti 2022		Buxheti 2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Pagat e punonjësve	25,000	21,208	25,000	21,591	25,585	21,521	27,500	-
Kontribute të sigurimeve shoqërore	4,000	3,411	4,100	3,570	4,200	3,552	4,500	-
Fondi i vecantë	1,000	-	1,000	855	1,205	638	1,265	-
Pagat e Këshillit Mbikqyrës	2,100	1,852	2,500	2,320	2,500	2,336	2,600	-

Sa sipër rezulton se Fondi i Pagave dhe Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për; Ndaj Listë Pagesave janë bërë:

a. Ndalesat e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (pjesa e të punësuarit).

b. Ndalesat e tatimit mbi të ardhurat. Respektivisht, sipas periudhave:

Sigurimet shoqërore janë llogaritur dhe mbajtur konformë:

- ✓ Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nenligjore.

Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi janë llogaritur dhe mbajtur konformë:

	✓ Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Agjencia e Trajtimit të Kredive, ka llogaritur dhe derdhur në kohë të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shendetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi që rrjedhin nga pagat e personelit. Gjatë vitit 2020, 2021, 2022 dhe 2023, veprimtaria e Agjencisë Trajtimit të Kredive është financuar nga arkëtimet e veta:
Baza rregullatore	Në zbatim të Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar”. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore.
Problematika e konstatuar	Planifikim i buxhetit dhe miratim mbi kufirin ligjor të shpenzimeve sipas ligjit. Mangësi në vendosjen e procedurave dhe afateve të planit buxhetor. Mangësi në vendosjen e procedurave në rregullore për shpalljen, rekrutimin, seleksionimin e burimeve njerëzore të ATK.
Impakti i gjetjes	Cënim i aktivitetit, rezultateve dhe efektivitetit të punës agjencisë.
Risku	I mesëm
Rekomandim nr.8	Organet drejtuese të vendosin rregulla dhe afate për argumentimin e planit buxhetit të agjencisë.
Risku	I Lartë
Rekomandim nr.9	Të merren masa për plotësimin e kuadrit rregullator të procedurave të shpalljes rekrutimit dhe seleksionimit të burimeve njerëzore të institucionit.
Koment nga pala e audituar	Rekrutimet bëhen në përputhje me Kodin e Punës dhe Ligjin e statusit civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe manualet e përcaktuara nga DAP duke respektuar për analogji, procedurën që ndiqet për rekrutimin, afatet, njoftimet, të drejtën e ankimit etj. Në faqen e internetit janë të shpallura vendet vakante, në aplikim janë specifikuar kriteret e përgjithshme dhe specifike në bazë të pozicionit përkatës.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	Komentet tuaja janë reflektuar më lart në raport. Rregullat që ndiqen për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit duhet të detajohen në rregulloren e institucionit. <u>Rekomandimi nuk ndryshon.</u>

MASA nr.5

Lidhja me programin e auditimit.	III. Auditimi financiar. Zbatimi i rregullave ligjor në fushën e shpenzimeve kapitale/investimeve dhe shpenzimeve të tjera, shërbimeve të siguruara me prokurim publik. Zbatimi i rregullave për menaxhimin e kontratës, marrja në dorëzim para pagesës. Siguria në ruajtjen e aseteve, inventarizimet periodike, dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Dokumentimi i pronësisë mbi asetet e paluajtshme të trupëzuara.
Gjetja	ATK-ja nuk disponon çertifikatë pronësie për 18 pronat e sekestruara por ka vetëm vërtetim hipotekor pa harta treguese dhe planvendosje të këtyre pasurive.
Përshkrimi i gjetjes	Nga verifikimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezulton se ATK-ja disponon inventar të pronave të cilat ajo administron gjithësej 77 prona të sekuestruara. Nga verifikimi i dokumentacionit që vërteton pronësinë e këtyre pasurive rezulton se për 59 pasuri ATK-ja në shtetë pajisur me certifikatë pronësie nga ASHK-ja, ndërsaq për 18 prona nuk ka dokumentacionin e kërkuar ligjor por disponon vetëm një vërtetim hipotekor. Mos azhurnimi dhe plotësimi i dokumentacionit për këto pasuri përbën rrisht të lart për tjetërsimin e pronësisë si dhe nuk i lejôn ATK-së vazhdimin e procedurave për shitjen dhe nxjerrjen në anakand të këtyre pasurive të sekuestruara. Konstatohet se ATK ka në regjistër prona për të cilat nuk kanë çertifikatë pronësie të sekuestruara që para 10 viteve dhe mospajisja me dokumentacionin e kërkuar tregon pamundësinë e administrimit nga ATK-ja, të këtyre pronave. Në përfundim grupi i auditit arrin në konkluzionin se ATK-ja të analizoj rast pas rasti këto pasuri duke i pajisur me certifikatë pronësie sipas legjislacionit në fuqi. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nga Drejtoria e Financës disponohet një regjistri kontabël i Aktiveve që zotron ose që i administron konformë pikës 26 dhe 30, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 <i>“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”</i>. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për periudhën e audituar është bërë inventarizimi i aseteve në fund të çdo viti kalendarik. Referuar udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”</i>, kreu IV <i>“Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”</i>, pika 74, përcaktohet se: <i>“Çdo njësi ekonomike duhet të kontrollojë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.</i> Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se me urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Trajtimit të Kredive nr .42 Prot datë 07.01.2021, <i>“Për kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët për vitin 2020”</i> është ngritur komisioni i inventarizimit fizik në magazinën qendrore, në zyrat e Drejtorisë të përgjithshme të ATK-së dhe degët nëpër rrethe, konform Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”</i>.

	Komisioni është i përbërë nga kryetarja Znj. _____ dhe dy antarët Znj. _____ dhe Z. _____. Referuar Relacionit nr 42/1 Prot datë 02.04.2021, Magazina në Drejtorinë e Përgjithshme pas kryerjes të inventarit fizik të Zyrave të Drejtorisë të Përgjithshme, të Magazinës Qëndrore, të Ish- zyrës Rajonale Lushnjë në prezencë të magazinierit dhe në krahasim me gjendjen kontabël nuk vëren asnjë diferencë për vitin 2020. Ish zyra Rajonale Korçë rezulton me diferencë për 18 artikuj të vjedhur sipas proces-verbalit datë 24.10.2013, vlera e të cilave është 663,779.19 lekë për të cilat është bërë denoncim në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Korçë në datë 24.10.2013. Nga inventari rezulton se Ish –Zyra Rajonale Pogradec është tjetërsuar në një subjekt privat dhe nuk gjenden materialet e cila kjo zyrë posedonte printer dhe kompjuter komplet në vlerën 79,189 lekë. Për këtë është bërë denoncim në datën 06.12.2017 në Drejtorinë e Policisë Pogradec. Në Ish zyrën Rajonale Kukës nga inventarizimi i kryer rezulton se mungon automjeti ISUZI (i cili nuk ka qenë në gjendje pune) me targën _____ në vlerën 765,000 lekë, i cili ka qenë i parkuar brenda pronës së rrethuar të debitorit _____. Është ngritur një grup pune sipas urdhërit të shërbimit Nr 3104/1 Prot datë 24.05.2021 , i cili ka bërë denoncimin e vjedhjes të automjetit sipas procesverbalit datë 27.05.2021. Sipas proces- verbalit datë 20.03.2012 rezulton se ka diferenca në artikujt e vjedhur, të cilat zenë vlerën 649,150 lekë për të cilët është bërë denoncim në Komisariatit e Policisë të Rrethit Kavajë. Gjithashtu Tollonat e _____ sha 1807 tollona, 18070 litra në vlerën 2,346,208.85 lekë janë gjendje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuar nga kjo e fundit si provë për gjykimin e padisë të depozituar nga ATK në datë 26.09.2014. Një tjetër konstatim është mungesa e automjetit me targë _____ i cili është sekuestruar nga Policia, i cili ndodhet në Drejtorinë Rajonale të Materialeve të Rezervave të Shtetit. Me urdhër të brendshëm nr 6411 Prot datë 20.12.2021 është ngritur komisioni për kryerjen e inventarit fizik të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët për vitin 2021 me përbërje Z. _____, Z. _____ dhe Z. _____. Në prani të Magazineres Znj. _____. Janë evidentuar inventari në përdorim për cdo punonjës të institucionit, si dhe inventari në magazinën e Agjencisë Trajtimit të Kredive. Për rezultatet e inventarizimit, komisioni ka paraqitur relacionin përkatës për titullarin e Institucionit, ku është raportuar për procesin e inventarizimit, gjendjen e AQT-ve dhe inventarin . Për vitin 2021 janë po të njëjtat diferenca si për vitin 2020. Me Urdhërin e Brendshëm nr. 2320 prot. datë 02.04.2021 “ Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve” është ngritur komisioni me kryetar _____ dhe anëtar Znj. _____, si dhe Znj _____, ku komisioni vlerësoi gjendjen fizike dhe funksionale të 122 artikujve me vlerë të mbetur 67,581.55 lekë, të cilat sipas procesverbalit datë 14.04.2021 në prezencë të komisionit të asgjesimit të vlerave materiale të ngritur sipas Urdhërit të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 2524 prot datë 12.04.2021 i cili përbëhet nga anëtarët _____, Z. _____,
--	--

Z. _____ Znj. _____ dhe Z. _____ në bazë të udhëzimit Nr 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë të Financave “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është bërë asgjesimi i artikujve.

Për vitin 2022 është ngritur komisioni i inventarizimit sipas Urdhërit të Brendshëm “Për kryerjen e inventarit të mjeteve kryesore dhe inventarit të imët për vitin 2022” me kryetare Znj. _____ dhe antarë Znj. _____ Znj. _____ sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”. Nga kryerja e inventarizimit të aktiveve të ATK-së, nga ana e Komisionit të Inventarizimit janë konstatuar aktive të cilat janë propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Për inventarizimin e vlerave material, janë mbajtur procesverbale të cilat janë të firmosura nga të gjithë antarët e komisionit dhe punonjësit përgjegjës material.

Diferencat midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike janë të cituara në procesverbale.

Rezulton se para nxjerrjes së bilancit është bërë rakordimi i gjendjes fizike me atë kontabël.

Për periudhën objekt auditimi nuk ka patur investime kapitale. Shpenzimet e kryera me prokurim publik kanë qenë të karakterit funksional të aktivitetit të ATK.

Janë hartuar Rregjistrat e parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2020 e 2021, dhe 2022 drejtuar Agjencisë Prokurimit Publik.

Rregjistrat e Prokurimeve Publike, janë miratuar nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për vitin 2020, 2021 dhe 2022.

Në fillim të çdo viti Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka ngritur Komisionin e prokurimit me vlerë të vogël sipas Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publike, “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Janë kryer 5 prokurime publike në formatin elektronik të APP me vlerë deri në 5 milion lekë. Nuk rezultuan mangësi në zhvillimin e procedurave dhe marrjen në dorëzim të asetit apo shërbimit të prokuruar.

Në mënyrë të përmbledhur për periudhën objekt auditimi shpenzimet e kryera me prokurime sipas natyrës paraqiten si më poshtë:

	Nr .	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
2020						
	1	Blerje bateri Automjeteve dhe Gjeneratori	41666.00	36000.00	_____	_____
	2	Blerje Kancelari dhe Tonera	666666.00	467917.00	_____	_____

		3	ING. Mekanik per konsumin e automjeteve dhe gjeneratorin	125000.00	101000.00		
		4	Materiale mbrojtese lidhur me COVID - 19	100000.00	39805.00		
		5	Materiale Pastrimi	100000.00	99850.00		
		6	Mirembajtja e automjeteve	166666.00	144000.00		
		7	Mirembajtja e faqes zyrtare te ATK-se	83333.00	75000.00		
		8	Riparim dhe lysterje te zyrove	416666.00	397000.00		
		9	Shërbim auditimi bilanci financiar	333333.00	330000.00		
		10	Shërbim mirëmbajtje paisje elektronike dhe zyrove.	416666.00	258900.00		
		11	Shërbime për riparimin e Automjeteve	166666.00	67500.00		
					64400.00		
					30000.00		
		12	Siguracion automjetesh	40000.00	19700.00		
	2021	1	Blerje materiale Kancelari dhe Tонера	500000.00	444000.00		
		2	Blerje materiale mbrojtese Covid-19	166666.00	140000.00		
		3	Blerje pajisje Elektronike	666666.00	630000.00		
		4	Materiale pastrimi	100000.00	99820.00		
		5	Mirëmbajtje e faqes EEB	83333.00	75000.00		
		6	Mirembajtje te Automjeteve (Lavazh)	141666.00	139000.00		
		7	Rikonstruksion i Zyrove	500000.00	343000.00		
		8	Ruajtje objekti me sistem alarmi	183333.00	182000.00		
		9	Shërbim auditimi bilanci financiar	333333.00	330000.00		
		10	Shërbime për riparimin e Automjeteve	583333.00	237250.00		
		11	Shpenzime vaj filtra, alkoll freni etj.	250000.00	21800.00		
		12	Siguracion automjetesh	40000.00	35431.00		

		1	Blerje fotokopje dhe printeri	250000.00	194000.00		
		2	Blerje goma per automjetet	166667.00	66000.00		
		3	Blerje Paisje Zyre	3750000.00	3665000.00		
		4	FV kondicionere	1666666.00	982634.00		
		5	Kancelari + Toner	500000.00	149000.00		
	2022	6	Lyerje dhe punime te brendshme gipsi	1250000.00	1218870.00		
		7	Materiale pastrimi	125000.00	62500.00		
				62500.00	59000.00		
		8	Mirëmbajtje e faqes Ëeb	100000.00	78000.00		
		9	Ruajtje objekti me sistem alarmi	333333.00	149999.00		
		10	Shërbim auditimi bilanci financiar	333333.00	320000.00		
		12	Shërbime për riparimin e Automjeteve	583333.33	143900.00		
				439433.00	190000.00		
		13	Shpenzime ne rast transferim zyresh	833333.00	710000.00		
		14	Shpezime per bateri Automjete dhe gjeneratori	41666.66	40000.00		
		15	Siguracion automjeteve	66666.67	19483.00		
Baza rregullatore	Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive “, i ndryshuar”. VKM nr.681, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave Udhëzim nr.33, datë 24.9.2010 “Për trajtimin e kredive të transferuara etj”. Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Ligji nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve” Ligji nr.. 162 /2020 Për Prokurimin Publik VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,						
Problematika e konstatuar	Nuk disponohet dokumentacioni ligjor të pronësisë së pasurive të sekuestruara. Problematikë e trashëguar prej vitesh.						
Impakti i gjetjes	Mos plotësimi i dokumentacionit për pronat e sekuestruara pengon trajtimin e mëtejshëm procedural të tyre.						
Risku	I lartë						

Rekomandim nr.10	ATK-ja të marrë masat e duhura për pajisjen e pasurive të konfiskuara nga debitorët ndër vite me dokumentacionin e pronësisë konformë kërkesave të legjislacionit.
Koment nga pala e audituar	Për rastet e mësipërme është kërkuar takim me drejtorinë e përgjithshme të ASHK-së për të gjetur zgjidhje për aplikimet në vazhdimësi. ATK do të vijojë përpjekjet për gjetjen e dokumentacionit si dhe do të tentojë të kryejë aplikime përsëri për nxjerrjen e dokumentacionit të pronësisë.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit	Sqarimet tuaja janë në mbështetje të rekomandimit. <u>Rekomandimi nuk ndryshon.</u>

MASA nr.6	
Lidhja me programin e auditimit.	III. Auditimi financiar. Vlerësimi mbi plotësinë dhe saktësinë e dokumentimit/ justifikimit të çdo lloji shpenzimi korent (operativ), respektimi i regullave, kuotave për kategori shpenzimesh, si dhe verifikimi i saktësisë së llogaritjeve të shumave të paguara për çdo lloj transaksioni. Zbatimi i standarteve në kontabilizimin e transaksioneve, rakordimin e llogarive, dhe raportimin financiar. Saktësia, plotësia dhe besueshmëria e pasqyrave financiare. Raportimi dhe miratimi i tyre nga organi më i lartë drejtues.
Gjetja	- Nga pasqyrat gjendjes së llogarisë “Kredi të humbura” jashtë bilancit nga viti 2016 deri në vitin 2022, rezultoi se, niveli mesatar vjetor i arkëtimit për principalin në lekë është 1.2% në vit, për principalin në euro është 0.9% në vit dhe për principalin në dollar është 0.7% në vit. - ATK, Në zbatim të nenit 8, pika 1 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” i ndyshuar, në aktiv të bilancit, nuk ka të pasqyruara si debitor kreditë e transferuarara tek kjo agjenci, nga bankat Tregtare të nivelit të dytë me kapital tërsisht shtetëror, por këto kredi i mban jasht bilancit në një pasqyrë “Kredi të humbura”. Mbajtja jasht bilancit si “Kredi të humbura” është bërë me argumentin se këta debi janë 100% të provigjonuara. - Debitorët e ATK-së, nuk janë krijuar nga veprimtaria e kësaj Agjencie, por janë debitorë të bankave të transferuara tek kjo agjenci në zbatim të ligjit. Për rrjedhojë provigjonimi i tyre nuk mund të bëhet nga ATK, por vetëm nga shteti me akte ligjorë. - Ndjekja e arkëtimit të detyrimeve, nga sektori i Financës, bëhet bazuar në të dhënat e hedhura në programin e kreditit më 01.01.2004, të dhëna të cilat janë integruar në sistemet e kreditimit të ndërtuara në periudha të mëvonshme. - Në ditarin analitik të bankës për vitin 2021 është regjistruar shuma 15,450 mijë lekë, me përshkrimin arkëtuar për shitje prone me ankand nga “ ” shpk. Sistemimi në kartelën e debitorit u realizua gjatë shqyrtimit të projekt raportit.

- Sektori i financës nuk prodhon raporte kontabël sipas përcaktimit në Aneksin nr.2, Moduli Financiar të kontratës nr.896/20, datë 05.05.2022, me përjashtim të raporteve mbi arkëtimin e kredive dhe të pagesave për shpenzime, raporte të cilat kanë qenë prodhuar dhe para ndërrimit të këtij sistemi. Aktualisht kontabiliteti mbahet manualisht në excel me sitemin ditar centralizator.
- ATK, ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022. Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021 janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa Pasqyrat financiare të vitit 2022 janë hartuar nga Sektori i Financës, por aktualisht nuk ka një analizë dhe miratim të tyre nga strukturat e drejtimit të ATK-së.
 - Gjithashtu pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021 janë audituar nga ekspertë kontabël të autorizuar pas miratimit në Këshillin Mbikëqyrës, për rrjedhojë Raportet e auditimit nuk i kanë shërbyer vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës në miratimin e treguesëve financiar të vitit por vetëm drejtorisë për rregullimet e rekomanduara.
 - ATK, për vitin 2020, ka derdhur në buxhetin e shtetit 5,567 mijë lekë, ose 11% të arketimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 45,250 mijë lekë të arketimeve vjetore ose 89%. Për vitin 2021, ka derdhur në buxhetin e shtetit 20,219 mijë lekë ose 26% të arketimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 57,424 mijë lekë të arketimeve vjetore ose 76%. Për vitin 2022, ka derdhur në buxhetin e shtetit 29,566 mijë lekë ose 51% të arketimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 29,566 mijë lekë të arketimeve vjetore ose 49%. ATK, përveç pagesave të kredisë ndaj KFË nuk ka bërë asnjë derdhje tjetër në buxhetin e shtetit. Shuma e mbajtur nga arkëtimet e vitit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve korrente të vitit, si dhe gjendje në Bankë.
- Në kundërshtim me nenin 22, pika 2, të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” i ndyshuar, ATK, ka mbajtur në llogarinë e saj në vitin 2020 shumën 32,566 mijë lekë ose 64% të totalit të arketimeve të vitit, në vitin 2021, shumën 38,013 mijë lekë ose 49% të totalit të arketimeve të vitit dhe në vitin 2022, shumën 14,521 mijë lekë ose 24% të totalit të arketimeve të vitit.
- Megjithëse, këstitet për pagesë principali dhe interesa të kredisë ndaj KFË, të dërguara nga Drejtoria e Borxhit publik nuk janë objekt i veprimtarisë së ATK-së, nga kjo e fundit janë kontabilizuar si shpenzime të vitit në kredi të llogarisë “Kreditor të tjerë” KFË.
- ATK, nuk ka shlyer detyrimet vjetore ndaj KFË për të gjithë shumën e marrë nga Drejtoria e Borxhit Publik, për rrjedhojë detyrimet ndaj buxhetit të shtetit për mosshlyrje të kësteve vjetore janë rritur. Gjithashtu është rritur dhe teprica e llogarisë “Kreditorë të tjerë” me analizë KFË.
- Për vitet 2020, 2021 dhe 2022, detyrimi ndaj KFË –së është rritur me 948 mijë euro detyrimi ndaj KFË-së me 31.12.2015 ishte 330 mijë euro dhe më 31.12.2022 ka arritur në shumën 1,809 mijë euro duke u rritur për 7 vite me 1,479 mijë euro ose 4.5 herë më shumë se gjendja në fund të vitit 2015.
- Ritmi i rritjes së detyrimit të pashlyer ndaj KFË-së, përfaqson mosderdhje në buxhetin e shtetit të shumave sipas kësteve të dërguara nga Drejtoria e Borxhit Publik. Ky ritëm tregon për një pëkeqësim të performances së ATK-së.

Përshkrimi i gjetjes

Sipas Pasqyrës jasht bilancit për “Kredi të humbura” gjendja më 31.12.2020, 2021 dhe 2022 paraqitet në tabelën sa më poshtë:

	Spenzim e Gjyqi	Principal			Interesa		
	000/lekë	000/lekë	000/E u	000/\$	000/lekë	000/E u	000/Usd
31.12.20	119,432	4,314,183	5,473	8,120	10,802,529	2,294	11,694
31.12.21	119,175	4,253,571	5,409	8,052	10,645,197	2,267	11,638
31.12.22	117,173	4,204,145	5,366	8,000	10,539,306	2,248	11,640
21-20	(257)	(60,612)	(64)	(68)	(157,332)	(27)	(56)
22-21	(2,002)	(49,426)	(43)	(52)	(105,891)	(19)	2

Bazuar në pasqyrën e mësipërme rezultojnë se:

Më 31.12.2021, krahasuar me gjendjen më 31.12.2020 rezultojnë se:

- detyrimet për shpenzime gjyqi janë ulur me 257 mijë lekë
- detyrimet për principal në lekë janë ulur me 60,612 mijë lekë, në euro janë ulur me 64 mijë euro dhe në dollar janë ulur me 68 mijë usd.
- Detyrimet për interesa në lekë janë ulur me 157,332 mijë lekë, në euro janë ulur me 27 mijë euro dhe në dollar janë ulur me 56 mijë usd.

Më 31.12.2022, krahasuar me gjendjen më 31.12.2021 rezultojnë se:

- detyrimet për shpenzime gjyqi janë ulur me 2002 mijë lekë.
- detyrimet për principal në lekë janë ulur me 49,426 mijë lekë, në euro janë ulur me 43 mijë euro dhe në dollar janë ulur me 52 mijë usd.

Krahasuar me gjendjen 31.12.2016, më 31.12.2022 detyrimet për:

Shpenzime gjyqi janë ulur me 1,056 mijë lekë ose 0.9%,
 Principali në lekë është ulur me 332,871 mijë lekë ose 7.3%
 Principali në euro është ulur me 314 mijë lekë ose 5.5%
 Principali në dollar është ulur me 375 mijë lekë ose 4.5%
 Interesi në lekë është ulur me 229,747 mijë lekë ose 2.1%
 Interesi në euro është ulur me 34 mijë lekë ose 1.5%
 Interesi në dollar është rritur me 13 mijë lekë ose 0.1%

Konkluzion:

Nga të dhënat mbi ndryshimin e gjendjes së llogarisë “Kredi të humbura” jasht bilancit nga viti 2016 deri në vitin 2022 niveli mesatar vjetor i arkëtimit për principalin në lekë është 1.2% në vit, për principalin në euro është 0.9% në vit dhe për principalin në dollar është 0.7% në vit.

Në nenin 8, pika 1 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” i ndyshuar, përcaktohet se: Debitorët e bankës do të vlersohen si debitor të Agjencisë për të gjitha kreditë e transferuar prej saj, sipas këtij ligji. Agjencia gezon të drejtat që banka ka pasur mbi debitorin, duke përfshirë dhe ndryshimet që banka mund ti ketë bërë me marrëveshje ndërmjet debitorit dhe asaj ,përpara datës kur kredia është transferuar në pronësi të Agjencisë.

Referuar këtij neni ATK, nuk ka të pasqyruara në aktiv të bilancit si debitor të gjitha kreditë e transferuarara tek kjo agjenci, nga bankat Tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror.

E gjithë vlera e debitorëve të agjencisë duhet të evidentohet në kredi në një llogari “Marrëdhënie me buxhetin e shtetit” ose “Operacione me shtetin” si detyrim që agjencia ka arketimin e kredive për llogari të buxhetit të shtetit.

Deri në fund të vitit 2015, debitorët e bankave për kreditë janë vlerësuar si debitor të Agjencisë dhe janë evidentuar në aktiv të Bilancit si debitore dhe në pasiv si “Provigjon”. Nisur nga ky fakt në pasqyrat financiare të vitit 2016, janë hequr nga bilanci duke i mbajtur si llogari jasht bilancit me arsyetimin se janë konsideruara të provigjonuara 100%.

Vlen të theksojmë se subjektet krijojnë “Provigjone”, për të debitorët që janë krijuar nga objekti i veprimtarisë së tyre. ATK, objekt veprimtarie nuk ka patur dhënien e kredive por, trajtimin e kredive dhe të aseteve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, te kjo agjenci. Në këto kushte kjo Agjenci nuk mund të krijojë provigjone mbi debitorët e marrë me ligj të veçantë. E drejta e provigjonit i takon shtetit që ka krijuar agjencinë për arkëtimin e detyrimeve për llogari të tij.

Konkluzion:

Debitorët e ATK-së, nuk janë krijuar nga veprimtaria e këtij institucioni por janë debitorë të bankave të transferuara tek kjo agjenci në zbatim të nenit 8, pika 1 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” i ndyshuar. Për rrjedhojë provigjonimi i tyre bëhet nga shteti me akte ligjorë.

Nga sektori i Financës, ndjekja e arkëtimit të detyrimeve bëhet bazuar në të dhënat e hedhura në programin e kreditit më 01.01.2004, të dhënat e të cilit janë integruar në sistemet e kreditimit të ndërtuara në periudha të mëvonshme. Nga ky program sektori i financës prodhon raporte mbi arkëtimin e debitorëve, raporte mbi gjendjen në fillim dhe në fund të periudhës si dhe kartelën individuale të çdo debitori.

Nga krahasimi arkëtimeve të vitit 2021, sipas raportit të prodhuar nga sistemi i kreditit në sektorin e financës me ditarin analitik të bankës të mbajtur në (excel) rezultoi se;

Sipas ditarit të bankës nga “ ” shpk është arkëtuar për shitje prone me ankand shuma 15,450 mijë lekë. Krahësuar me raportin vjetor të prodhuar nga sistemi i kreditit kjo vlerë nuk është pasqyruar në kartelen e debitorit për rrjedhojë arkëtimet me bankë janë më shumë se arkëtimet nga sistemi i kreditit. Sistemimi në kartelën e debitorit u realizua gjatë shqyrtimit të projekt-raportit.

Në këto kushte është domosdoshmëri sistemimi i vlerës së arkëtuar nga ankandi në kartelën e debitorit në sistemin e kreditit.

Në kontratën nr.896/20, datë 05.05.2022 me objekt “Ndërtim Ëeb-Service dhe mirëmbajtje e sistemit të kreditimit”, Aneksi nr.2 Moduli Financiar faqe 21 përcaktohet: Moduli financiar përmban të gjitha akseset për regjistrimet periodike të dokumentave të një institucioni sipas standardeve në fuqi dhe raportimi mujor apo vjetor. Sipas këtij aneksi ky modul ofron mbajtjen e kontabilitetit, krijimin e dokumentave kontabele dhe prodhimin e ditarëve analitik, balanceve dhe të pasqyrave financiare sipas standardeve.

Aktualisht kontabiliteti mbahet manualisht në excel me sistemin ditar centralizator. Sektori i financës nuk prodhon asnjë raport kontabël sipas përcaktimit në Aneksin nr.2 Moduli Financiar të kontratë nr.896/20, datë 05.05.2022, me përjashtim të raporteve mbi arkëtimin e kredive dhe të pagesave për shpenzime, raporte të cilat kanë qenë prodhuar dhe para ndërrimit të këtij sistemi.

ATK, ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 dhe 2022.

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe janë analizuar nga Këshilli mbikëqyrës, i cili me vendim nr. 106, datë 29.04.2021 ka vendosur miratimin e treguesëve ekonomiko-financiarë të bilancit kontabël të vitit 2020, si dhe ka dhënë autorizim për auditimin e këtij bilanci nga ekspert kontabël i miratuar.

-Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2020 është depozituar nga eksperti kontabël me protokoll nr. 5361, datë 22.10.2021.

Pasqyrat financiare të vitit 2021 janë hartuar dhe janë analizuar nga Këshilli mbikëqyrës, i cili me vendim nr. 5, datë 22.06.2022 ka vendosur miratimin treguesëve ekonomiko-financiarë të bilancit kontabël të vitit 2021, si dhe ka dhënë autorizim për auditimin e këtij bilanci nga ekspert kontabël i miratuar.

-Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2021 është depozituar nga eksperti kontabël me protokoll nr. 4948, datë 21.12.2022.

Konkluzion: pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021 janë audituar nga ekspertë kontabël të autorizuar pas miratimit në Këshillin Mbikëqyrës, për rrjedhojë Raportet e auditimit nuk i kanë shërbyer vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës në miratimin e treguesëve financiar të vitit por vetëm drejtorisë për rregullimet e rekomanduara.

Pasqyrat financiare të vitit 2022 janë hartuar nga sektori i financës, por aktualisht nuk janë analizuar dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ATK-së.

Nga Drejtoria e Borxhit Publik çdo vit është përcjellë detyrimi për shlyerje të kredisë me KFË-në, detyrim, që ATK-ja duhet të paguaj nga vlera arkëtimeve për llogari të buxhetit të shtetit.

Të dhënat e detyrimeve sipas viteve object auditimi paraqiten në pasqyrën sa më poshtë:

Emertimi	Vitet		
	2020	2021	2022
Interesa në euro	42,079	39,803	35,528
Principal në euro	436,702	436,702	437,213
Shuma në euro	478,781	476,505	472,741
Pagesë kredie në euro	45,000	167,432	268,000
Pagesa në 000/lekë me kursin kontabël	5,567	20,219	30,617
Diferenca në euro	433,781	309,073	204,741
Arkëtime në 000/lekë sipas PASH-it	50,817	77,643	60,180
Mbajtur në përdorim nga ATK në 000/	45,250	57,424	29,566
I takon të mbajë sipas ligjit	12,704	19,411	15,045
Mbajtur në kundërshtim me ligjin	32,566	38,013	14,521
Raporti derdh buxhet/arkëtime gjithsej	11	26	51
Kaluar në Shpenzime në 000/lekë	59,225	57,543	54,001

Shuma e kredisë së KFË, paguar nga ATK-ja çdo vit është rakorduar me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe është vlerësuar si derdhje në buxhet nga arkëtimet e vitit. Referuar nenit 22, pika 1, të ligjit Arkëtimi nga debitorët për shlyerjen e kredive për llogari të buxhetit të shtetit, Brenda dates 5 të muajit pasardhës duhet të derdhen në buxhet

ATK, përveç shumave të paguara për shlyerjen e kredisë ndaj KFË nuk ka bërë asnjë derdhje tjetër në buxhetin e shtetit.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se:

-ATK, për vitin 2020 ka derdhur në buxhetin e shtetit 5,567 mijë lekë të vlerësuar me kursin kontabël ose 11% të arkëtimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 45,250 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 89%.

-Për vitin 2021 ka derdhur në buxhetin e shtetit 20,219 mijë lekë të vlerësuar me kursin kontabël ose 26% të arkëtimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 57,424 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 76%.

-Për vitin 2022 ka derdhur në buxhetin e shtetit 29,566 mijë lekë të vlerësuar me kursin kontabël ose 51% të arkëtimeve vjetore dhe ka mbajtur për përdorim 29,566 mijë lekë të arkëtimeve vjetore ose 49%.

Shuma e mbajtur nga arkëtimet e vitit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve korrente të vitit si dhe gjendje në Bankë.

Në nenin 22, pika 2 të ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimet të Kredive” i ndyshuar, përcaktohet se: Agjencia mban në llogaritë e veta fonde të barabarta në vlerë me $\frac{1}{4}$ e buxhetit operativ vjetor të Agjencisë, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Referuar këtij neni ATK, duhet të mbante nga arkëtimet e vitit 2020, shumën 12,704 mijë lekë, nga arkëtimet e vitit 2021, shumën 19,411 mijë lekë dhe nga arkëtimet e vitit 2022, shumën 15,045 mijë lekë.

Nga sa sipër arrijmë në konkluzion se:

ATK, ka përdorur në kundërshtim me këtë nen të ligjit në vitin 2020 shumën 32,566 mijë lekë ose 64% të totalit të arkëtimeve të vitit, në vitin 2021, shumën 38,013 mijë lekë ose 49% të totalit të arkëtimeve të vitit dhe në vitin 2022, shumën 14,521 mijë lekë ose 24% të totalit të arkëtimeve të vitit.

Referuar pikës 2 të nenit 22 të ligjit vetëm 25% e vlerës së arkëtuar duhet të kontabilizohet si e ardhur për ATK-në duke pakësuar (debituar) llogarinë “Marrëdhënie me buxhetin e shtetit”.

ATK, të gjithë vlerën e arkëtimeve vjetore e ka vlerësuar të ardhura. Referuar nenit 22 të ligjit të gjithë arkëtimet nga debitorët duhet të vlerësoheshin si detyrim ndaj buxhetit të shtetit dhe duhet të kontabilizoheshin në llogarinë “Marrëdhënie me buxhetin e shtetit” ose “Operacione me shtetin” dhe vetëm $\frac{1}{4}$ e vlerës së arkëtuar sipas ligjit duhet të mbahej si e ardhur e ATK-së duke debituar llogarimë “Marrëdhënie me buxhetin e shtetit” ose “Operacione me shtetin”.

-ATK, detyrimet për principal dhe interesa të dërguara nga Drejtoria e Borxhit publik i ka kontabilizuar si shpenzime të vitit në kredi të llogarisë “Kreditor të tjerë” KFË. Këstet për pagesë të kredisë ndaj KFË nuk janë object i veprimtarisë së ATK, por janë detyrim që ATK duhet të paguaj për llogari të shtetit nga arkëtimet vjetore, si të tilla duhet të kontabilizohet në debit të llogarisë “Operacione me shtetin” me analizë këst kredie për KFË-në dhe në kredi të llogarisë “Kreditorë të tjerë” KFË.

-Për vlerën e detyrimit të paguar ndaj KFË, krahas veprimit të pagesës së KFË-së me bankë duhet të kryhet veprimi paralel duke kredituar llogarinë “Operacione me shtetin” për këstet e kredisë ndaj KFË-së dhe Debitimi i llogarisë “Operacione me shtetin” për arkëtim nga debitorët e ATK-së. Shuma e kredisë së paguar përfaqëson derdhje në Buxhetin e Shtetit nga arkëtimet e vitit.

-Teprica debitore e llogarisë “Operacione me shtetin” për këstet e kredisë ndaj KFË-së pasqyron detyrimin e kredisë së pa shlyer dhe duhet të rakordojë me llogarinë “Kreditorë të tjerë” në analizë KFË.

	Ndërsa në pasiv teprica e llogarë “Operacione me shtetin” për arketim nga debitorët e ATK-së duhet të pasqyrojë vlerën e arkëtuar për llogari të buxhetit dhe të pa derdhur. <u>Nga analiza e llogarisë “Kreditorë të tjerë” KFË rezulton se:</u> Detyrimet vjetore ndaj KFË, ATK, nuk i ka shlyer për të gjithë shumën e marrë nga Drejtoria e Borxhit Publik për rrjedhojë janë rritur detyrimet ndaj buxhetit të shtetit nga mosshlyrja e kësteve vjetore, si dhe është rritur teprica kreditore ndaj KFË-së. Për tre vitet gjithësej detyrimet ndaj KFË –së janë rritur me 948 mijë euro nga të cilat në vitin 2020, janë rritur me 434 mijë euro, në vitin 2021 janë rritur me 309 mijë euro dhe në vitin 2022 janë rritur me 205 mijë euro. Detyrimet ndaj KFË-së me 31.12.2015 ishin 330 mijë euro dhe më 31.12.2022 kanë arritur në shumën 1,809 mijë euro duke u rritur për 7 vite në shumën 1,479 mijë euro osë 4.5 herë më shumë. Ritmi i rritjes së detyrimit të pashlyer ndaj KFË-së, përfaqson mosderdhje në buxhetin e shtetit të shumave sipas kësteve të dërguara nga Drejtoria e Borxhit Publik. Ky ritëm tregon për një pëkeqësim të performances së ATK-së.
Baza rregullatore	Në zbatim të Ligji nr. 8894 datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar”. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore. Ligji nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.
Problematika e konstatuar	Vlera e arkëtuar me bankë në 2021 nga “ ” shpk në shumën 15,450 mijë lekë, me përshkrimin shitje prone me ankand nuk është pasqyruar si arketim dhe si paksim të kartelës së debitorit në sistemin e kreditit. -Mosrespektim i raportit të vlerë së mbajtura nga ATK-ja dhe të derdhura në buxhet nga shuma vjetore e arkëtimeve nga debitorët. -Kontabilizimi i arkëtimeve vjetore si të ardhura të agjencisë dhe jo si arketim për tu derdhur në buxhet. -Rritje të detyrimit ndaj KFË-së nga mospagesa e plotë e kësteve vjetore të kredisë
Impakti i gjetjes	Arkëtimet me bankë janë më shumë se arkëtimet nga sistemi i kreditit dhe pasaktësi në shkarkimin e detyrimit nga kartela e debitorit. Mospektim i raportit të vlerë së mbajtura nga ATK-ja dhe të derdhura në buxhet, si dhe kontabilizimi i arkëtimeve vjetore si të ardhura të agjencisë ka patur ndikim në zbatimin e ligjit “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” Rritje të detyrimit ndaj KFË-së nga mospagesa e plotë e kësteve vjetore të kredisë ka ndikuar në performancën e agjencisë.
Risku	I Lartë
Rekomandime	Rekomandim nr.13 i lënë në projekt raport;

	Agjencia e Trajtimit të Kredive dhe Sektori i Financës të bëjnë sistemimin e vlerës 15,450 mijë lekë në arkëtimet e sistemit të kreditit si dhe shkarkimin e karteles së debitorit për vlerën e arkëtuar nga ankandi.
Koment i palës audituar	Debitori ka dy kredi. Me veprimin nr.35080 datë 21.06.2016 është zbritur vlera e pronës kontabilizuar në shumën 37,326,400 lekë. Me veprimin nr.1567 datë 11.07.2023 u bë sistemimi në ditar në të dyja kartelat për shumën 21,876,400 lekë që është diferenca e pronës më pak se vlera e kontabilizuar.
Konkluzion përfundimtar i grupit auditimit për	Referuar sqarimit dhe kartelës të vënë në dispozicion rekomandimi nr.13 i lënë në projekt raport është i realizuar dhe nuk lihet në planin e veprimit përfundimtar. 1. Komenti i dhënë nga ATK me observacionin mbi raportin e arkëtimeve nga debitorët të përdorur nga ATK që nga viti 2015 deri në vitin 2022, janë në mbështetje të konkluzionit të auditimit, por nuk ka asnjë indici apo propozim të dokumentuar në vite për rregullimin e këtij raporti në përputhje me ligjin. ATK duhet të marrë masa që të eliminojë paligjshmërinë. 2. Komenti i dhënë nga ATK mbi mbajtjen e kontabilitetit dhe prodhimin e raporteve financiare nga sistemi elektronik janë në mbështetje të konkluzionit të auditimit dhe i shërbejnë të ardhmes në përmirësimin e sistemit me qëllim që kontabiliteti të mos mbahet manualisht në excel, por të shfrytëzohet kapaciteti i sistemeve elektronike të instaluar. 3. Komenti i dhënë nga ATK mbi pasqyrat financiare të vitit 2020,2021 dhe 2022 si dhe auditimi i tyre nga ekspertë kontabël të autorizuar janë marrë në konsideratë pjesërisht dhe janë bërë rregullimet e duhura në këtë raport.
Rekomandim nr.11	Drejtorja dhe Këshilli Mbikëqyrës i ATK-së, të analizojnë dhe të marrin vendime për çështjet e trajtuara në raport lidhur me debitorët, arkëtimet, derdhjet në buxhet si dhe treguesit e performances së agjencisë.

Grupi i auditimit falenderon njësinë e audituar për bashkëpunimin e mirë për realizimin e këtij auditimi.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Agjencia e Trajtimit të Kredive brenda 30 ditësh, duhet të hartojë dhe miratojë planin e veprimit përfundimtar në zbatim të rekomandimeve dhe të njoftojë Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.

Grupi i auditimit